# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6222
E hënë, 25 janar 2021
çmimi 0.40 €

## Ujkani: Partitë politike duhet të kenë një pako të veçantë për investitorët e huaj

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



PËR MOSCERTIFIKIM TË LISTAVE, SUBJEKTET POLITIKE ANKOHEN NË PANELIN ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTESA (PZAP) FAQE 3

# VJOSA OSMANI KRITIKOHET PËR PRESION NDAJ KQZ-së

Ushtruesja e detyrës e presidentes të Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë kritika të shumta për "qortimin" e fundit ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Juristë të njohur, shoqëria civile dhe subjektet politike kanë vlerësuar se vërejtjet e Osmanit ndaj KQZ-në janë kërcënim ndaj këtij institucioni të pavarur. Sipas tyre, kjo mund të interpretohet edhe si shkelje e Kushtetutës, ndërhyrje në punët e një institucioni të pavarur dhe favorizim i një subjekti politik

FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI DEHARI FAQE 4-5

## PËR DEPUTET MË PROPOZUAN SHUMË ANËTARË DHE SHOKË NGA VETËVENDOSJA, SYNOJMË MBI 60 MANDATE



Veprimtari i çështjes kombëtare dhe shkrimtari Avni Dehari, i cili është kandidat për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se i ka hyrë këtij gare pas propozimit nga shumë anëtarë dhe shokë të tij nga kjo lëvizje. Dehari në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka deklaruar se ai nuk mund të mos besojë se përpjekja për t'ia pamundësuar Albin Kurtit që t'i prijë listës së kandidatëve në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka prapavijë politike. Pavarësisht kësaj, Dehari beson se LV-ja në këto zgjedhje do t'i fitojë më shumë se 60 mandate. "Përshtypja ime, edhe pse nuk është reprezentative në kuptimin statistikor, është se ky numër i mandateve, që Lëvizja Vetëvendosje do të fitojë në këto zgjedhje, është më i madh se kaq", ka thënë Dehari



## NISMA PREZANTON KANDIDATËT PËR DEPUTETË, LIMAJ THOTË SE ATA DO TË JENË ZËRI I UÇK-së NË KUVEND

FAQE 5

### OPINION

**14 SHKURTI, KOSOVA DHE LIDERËT!** F. 7



Shkruan: Bedri ISLAMI

### AKTUALE



**HOXHAJ E ISMAILI PREMTOJNË RREGULLIMIN DHE ULJEN E ÇMIMEVE TË BARNAVE NË KOSOVË** F. 6

**GJASHTË TË VDEKUR, 222 TË SHËRUAR DHE 392 RASTE TË REJA ME COVID** F. 6

**KANDIDATURAT PËR PRESIDENT VËSHTIRËSOJNË ARRITJEN E KOALICIONEVE PASZGJEDHORE** F. 7

### EKONOMI

**PARATË NGA DIASPORA MBAJNË 'GJALLË' EKONOMINË** F. 8

**LV-ja DHE LDK-ja E MENDOJNË RIKTHIMIN E RECIPROCITETIT ME SERBINË** F. 8

### SPORT

**FEDERATA E GJIMNASTIKËS SHPALL MË TË MIRËT E VITIT 2020** F. 12



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Bideni dhe Johnsoni zotohen për thellim të lidhjeve në mes të kombeve të tyre





LONDËR, 24 JANAR - Kryeministri britanik, Boris Johnson dhe presidenti amerikan Joe Biden, janë zotuar më 23 janar për thellim të lidhjeve në mes të dy shteteve dhe të bashkëpunojnë për luftimin e ndryshimeve klimatike. Në bisedën e tyre të parë telefonike, prej kur Bideni ka marrë pozitën e presidentit, Johnson ka përgëzuar Bidenin, është thënë në një deklaratë nga zyra e kryeministrisë britanike. Aty është thënë edhe se të dy liderët kanë gatishmëri për "ta thelluar aleancën e ngushtë në mes të kombeve tona". Kjo thirrje telefonike ka ardhur një ditë pasi Bideni ka folur me kryeministrin kanadez, Justin Trudeau, njëherësh liderin e parë të huaj prej inaugurimit më 20 janar. Ai më vonë ka folur edhe me presidentin e Meksikës, Andres Manuel Lopez Obrador. "Më vjen shumë mirë që fola me presidentin Joe Biden", ka thënë Johnsoni në llogarinë e "Twitter". Liderët është thënë të kenë diskutuar edhe ndonjë marrëveshje potenciale për tregti të lirë në mes të Britanisë dhe ShBA-së. Johnsoni "ka theksuar qëllimin e tij për të zgjidhur çështjet tregtare ekzistenciale sa më shpejt që është e mundur", është përmendur në deklaratë. Mbretëria e Bashkuar ka rikthyer kontrollin e politikave për tregti kombëtare këtë muaj, pas përfundimit të periudhës tranzitore të Brexitit, mirëpo një marrëveshje e re tregtare në mes të aleatëve është prioritet më i madh për Johnsonin sesa për Bidenin. Johnsoni mes tjerash ka mirëpritur vendimin e Bidenit për të rikthyer ShBA-në në Marrëveshjen e Parisit për Klimën, dhe në Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Kryeministri britanik ka pëlqyer edhe përkushtimin e Bidenit për të arritur në emetime zero deri më 2050.

# Memoaret e hebrenjve të mbijetuar vënë në pah të vërtetat e harruara

SHKUP, 24 JANAR - Departamenti për Edukim dhe Hulumtimin e Holokaustit, i cili funksionon në kuadër të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITShKSh), ka në fokus zbardhjen e të vërtetës për shumë familje hebreje në trojet e ish-Jugosllavisë të cilat arritën të mbijetojnë gjatë Luftës së Dytë Botërore, falë ndihmës së familjeve shqiptare. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Skender Asani, drejtor i ITShKSh-së. "Me themelimin e këtij departamenti (Departamentin për Edukim dhe Hulumtimin e Holokaustit) të vetmin e kësaj natyre në Evropën Juglindore, menjëherë kemi filluar të botojmë ligjet anti-semitike, që janë sjellë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga Mbretëria e atëhershme e Bullgarisë, përkatësisht botimin e një libri nga autorë shqiptarë dhe maqedonas, në të cilin në formë të dokumentuar flitet për dëbimin e 7 mijë e 144 hebrenjve nga Maqedonia e Veriut drejt Treblinkës. Pastaj kemi filluar me fazën e dytë të veprimit të këtij institucioni, me ç'rast hulumtuesit e këtij departamenti shkuan në Izrael për t`i takuar të mbijetuarit e familjeve hebreje nga trojet e ish-Jugosllavisë, të cilat gjatë Luftës së Dytë Botërore të vetmin shpëtim e kanë pasur strehimin në trojet etnike shqiptare, përkatësisht familjet shqiptare me ndihmën e po shqiptarëve", ka thënë Asani. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Holokaustit, që përkujton 27 janarin e vitit 1945, kur forcat sovjetike e çliruan kampin Aushvic-Birkenau, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, ka botuar në katër gjuhë, shqip, maqedonisht, anglisht dhe hebraisht memoaret e familjes Altarac, përkatësisht Shella Cion Altarec nga Shtipi, qytet ky në lindje të Maqedonisë së Veriut dhe bashkëshortit të saj Braco Atarec nga Sarajeva.

Në këtë libër rrëfehet rrugëtimi i Shellës, si vajzë atëkohë, në vitin 1943 vetëm 7 vjeçe dhe si anëtarja e vetme e mbijetuar e familjes Altarac, e cila kalon nëpër shumë peripeci gjatë rrugëtimit nga Shtipi drejt Shkupit, dhe më pas duke jetuar një kohë në Prishtinë dhe Gjakovë.



Shella Altarac pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore strehohet në shtëpinë jetimore në Beograd prej ku është nisur në Izrael. Në intervistë për "Radion Evropa e Lirë", drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Skender Asani thotë se përmes këtyre rrëfimeve zbardhet një e vërtetë që qëllimisht është vënë në harresë nga ish-regjimi komunist. "Mbi 70 familje hebraike, gjatë takimeve që i kam pasur në Izrael, më kanë dhënë të drejtën autoriale që t'i botoj memoaret , duke filluar me memoaret e gruas hebreje Ita Bartuv dhe këtë radhe më 27 janar të këtij viti ne po promovojmë librin për vuajtjet e familjes Alltarac 'Fëmijëria e Humbur' rrëfimi mbi jetën dhe mbijetesën, duke u bazuar në memoaret e Shella Atrac atë kohë vetëm7 apo 8 vjeçare", ka thënë Asani, i cili ka botuar librin me memoaret e zonjës Shella Altarac.

Ai ka theksuar se familjet shqiptare në Maqedoninë e Veriut falë besës së dhënë edhe kundrejt kushteve të vështira ekonomike kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për strehimin dhe mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, për hebrenjtë jo vetëm nga Maqedonia e Veriut po edhe nga trojet e Bosnjës, Kroacisë, Sllovenisë dhe Serbisë të cilët arrinin në Shkup, që pastaj përmes ndihmës së shqiptarëve të kalojnë në Shqipëri, ku u pajisën me leje identifikimi dhe nënshtetësi shqiptare. "Pikërisht të gjithë këta hebrenj kanë arritur të shpëtojnë jetën falë shqiptarëve në këto troje, të cilët i kanë bartur familjet hebraike në vende të sigurta megjithëse shqiptarët në atë periudhë kanë qenë në gjendjen më të mjerueshme sa i përket gjendjes ekonomike, por atë mundësi që e kanë pas e kanë ndarë me hebrenjtë, për çka duhej trimëri pasi pa trimëri, guxim nuk do të mund të shpëtonin ata hebrenj që tani për fat të mirë janë gjallë dhe përmes rrëfimeve të tyre ne e kuptojmë realitetin e asaj kohe", ka thënë Asani. Ndryshe natën në mes 10 dhe 11 marsit të vitit 1943 janë arrestuar mijëra hebrenj nga qyteti i Manastirit, Shtipit dhe Shkupit duke i vendosur ata në kampin e përkohshëm të përqendrimit në Monopolin e Shkupit që njihet si Kombinati i Duhanit. Nga këto tri qytete, në Monopolin e Duhanit në Shkup, u mblodhën gjithsej 7 144 hebrenj, apo rreth 98 për qind e komunitetit hebre në Maqedoni të Veriut, në vitin 1943. Po në mars ata u dërguan në kampet e përqendrimit në Treblinka të Polonisë.

## Mijëra persona ndalohen në marshet për lirim të Navalnyt



Moskë, 24 janar - Mijëra rusë janë ndaluar në gjithë Rusinë, pas protestave në të cilat është bërë thirrje për lirim të liderit opozitar Aleksei Navalny, ndërkohë që policia ka tentuar t'i shtypë dhunshëm ato që janë konsideruar protestat më të mëdha kundër qeverisë në vitet e fundit në këtë vend. Navalny është burgosur fundjavën e kaluar teksa ka arritur në Moskë nga Gjermania. Në shtetin gjerman, Navalny është trajtuar pas helmimit me agjentin nervor "Noviçok". Ende nuk është bërë e qartë se çfarë efekti do të kenë protestat e 23 janarit për Qeverinë e presidentit rus Vladimir Putin, i cili vazhdon të ketë mbështetje nga populli. Në ndryshimet kushtetuese të bëra vitin e kaluar, Putinit i është mundësuar që potencialisht të qëndrojë në pushtet deri më 2036. Mirëpo dalja e dhjetëra mijëra personave në protestë nga Moska dhe Vladivostok, ka treguar për interesimin e popullit për fushatën e Navalnyt kundër korrupsionit. Deri më 24 janar, gati 3 300 persona janë raportuar të ndaluar në gjithë shtetin, bazuar në të dhënat e grupit vëzhgues, OVD-Info.

Pothuajse gjysma e ndalimeve është kryer në Moskë, duke përfshirë gruan e Navalnyt, Yulia, dhe njërën prej aleateve të tij më të afërta, Lybov Sobol, e cili është tërhequr zvarrë nga policia, teksa ka qenë duke folur me gazetarët. Pamjet e protestave me prezencë të madhe policore janë dënuar nga Uashingtoni dhe Moska. Ndalimi i Navalnyt dhe shtypja ndaj mbështetësve të tij japin "shenja shqetësuese për kufizime shtesë ndaj shoqërisë civile dhe lirive themelore", ka thënë zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price.

Shefi i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell, ka folur me keqardhje për "ndalimet" dhe "përdorimin e joproporcional të dhunës". Ministrat e jashtëm të bllokut evropian do të diskutojnë për "hapat e ardhshëm" më 25 janar, ka thënë ai në një postim në "Twitter". Këto deklarata kanë nxitur reagime nga Ministria e Jashtme e Rusisë, e cila ka pretenduar se Shtetet e Bashkuara kanë ndihmuar për nxitjen e protestave.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

PËR MOSCERTIFIKIM TË LISTAVE, SUBJEKTET POLITIKE ANKOHEN NË PANELIN ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTESA (PZAP)

# Vjosa Osmani kritikohet për presion ndaj KQZ-së

Ushtruesja e detyrës e presidentes të Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë kritika të shumta për "qortimin" e fundit ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Juristë të njohur, shoqëria civile dhe subjektet politike kanë vlerësuar se vërejtjet e Osmanit ndaj KQZ-në janë kërcënim ndaj këtij institucioni të pavarur. Sipas tyre, kjo mund të interpretohet edhe si shkelje e Kushtetutës, ndërhyrje në punët e një institucioni të pavarur dhe favorizim i një subjekti politik



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 JANAR - Vërejtjet e ushtrueses së detyrës të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, ndaj kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, janë kundërshtuar nga subjektet politike, shoqëria civile dhe juristë të njohur. Ata kanë thënë se paralajmërimi i Osmanit, se mund të marrë masa ndaj kryetares së KQZ-së, është kërcënim dhe ndërhyje në punën e KQZ-së si institucion i pavarur. Sipas tyre, në këtë mënyrë Osmani po shkel Kushtetutën dhe po favorizon një grup politik. Juristi Dastid Pallaska ka thënë se ky veprim i ushtrueses së detyrës së presidentes është gabim i madh për tri arsye. "Së pari, po qe se ajo do të konsideronte se në takimin e djeshëm të KQZ-së kryetarja ka kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm apo të padenjë, ushtruesja e detyrës e presidentes do të duhej ta identifikonte këtë veprim me saktësi dhe ta procedonte menjëherë shkarkimin. Këtë, mbase, nuk ka mundësi ta bëjë sepse kryetarja e KQZ-së dje vetëm zbatoi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese që i detyron të gjithë", ka shkruar Pallaska në profilin e vet në "Facebook", duke ngritur edhe çështjen e konfliktit të interesit në këtë rast. "Së dyti, duke heshtur linçimin publik, të cilit i është nënshtruar kryetarja e KQZ-së nga partia politike me të cilën garon ushtruesja e detyrës e presidentes në këto zgjedhje, ajo dështoi ta përmbushë detyrimin kushtetues të paanshmërisë politike gjatë ushtrimit të funksioneve institucionale. Së treti, ky kërcënim dhe marrja e anës në një debat të pastër politik/elektoral, ngrehin pyetjen e konfliktit të hapur të interesit që ajo mund të ketë ndërmjet garës së vet zgjedhore dhe interesave të saj partiake karshi postit të presidentes të cilin aktualisht e ushtron", ka vlerësuar Pallaska.

Edhe Albert Krasniqi, jurist nga "D+" , ka përmendur çështjen e konfliktit të interesit të Osmanit në këtë rast. "Gjykata ka thënë se po të ngritët ndonjë konflikt i interesit, kur një ushtrues i detyrës së presidentit mund të ushtrojë konflikt të interesit për shkak se ai nuk është i shkoqitur nga posti i tij partiak", ka thënë ai për "T7". Madje, sipas tij, Osmani me këtë veprim ka shkelur edhe Kushtetutën e Kosovës. "Për mendimin tim, sot zonja Osmani ka bërë shkelje kushtetuese për shkak se ka ndërhyrë në punën e një institucioni kushtetues për të ekzekutuar një vendim që është në kundërshtim me Kushtetutën", ka thënë Krasniqi

### LDK-ja dhe PDK-ja: Osmani është shndërruar në militante të Kurtit

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë akuzuar ushtruesen e detyrës së presidentes, Vjosa Osmani, se me veprimet e fundit ndaj KQZ-së është shndërruar në aktiviste të liderit të LV-së, Albin Kurti.

Kandidatja për deputete e LDK-së, Ardita Dushi, ka thënë se të dielën është kërcënuar KQZ-ja.

Në një konferencë për media ajo ka thënë se KQZ-ja është kërcënuar nga ata që janë të obliguar ta mbrojnë atë. "Është shkelje për dy arsye: ndërhyrjeje në pavarësinë e saj dhe tentim për favorizim të një grupi politik. Kjo ndodh për herë të parë në Kosovë", ka thënë ajo, duke shtuar se LDK-ja kërkon nga të gjitha institucionet dhe KQZ-ja që të mos ndikohen nga kërcënimet, pavarësisht se nga kush vijnë ato. "LDK-ja i garanton qytetarët e Kosovës se vullneti i tyre i lirë nuk do të mund të ndryshohet nga kërcënimet dhe linçimet. Shteti duhet respektuar në plotësi – shteti duhet të ruhet sepse është i shenjtë", është shprehur ajo.

Kurse kandidatja për deputete nga radhët e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se Osmani është duke e shantazhuar kryetaren e KQZ-së. "Vjosa Osmani e ka ndërtuar karrierën e saj politike nën viktimizimin se si grua në politikë po goditej nga të gjitha anët. Gjatë aktivitetit të saj politik ajo e ka pasur gojën plot 'fuqizim të grave'. Por dje ajo nuk mundi ta mbante nën kontroll më hipokrizinë e saj duke qenë se tash është militante e Albin Kurtit dhe harroi për një moment gjithë vijën mbi të cilën është fuqizuar si politikane. Shantazhi i saj ndaj një gruaje të një institucioni të pavarur, znj. Valdete Daka, është dekurajim për qindra-mijëra gra që po tregojnë kurajën për angazhim, pjesëmarrjen në aktivizëm", ka shkruar Deliu-Kodra në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse anëtari i Partisë Socialdemokrate, Nol Nushi, ka deklaruar se Osmani e ka shndërruar zyrën e Presidencës në një nëndegë të Albin Kurtit. "Zëvendësimi i kapjes. Ajo çka ka bërë u. d. e presidentes Vjosa Osmani dje, është njëmend ndryshim. Por veç ndryshim i keqpërdorimit të institucionit. Kanë ndryshuar personi dhe diskursi, por institucioni ka ngelur i kapur. Është hera e parë që një presidente në detyrë, njëkohësisht është edhe në garë zgjedhore. Rrjedhimisht, Vjosa e ka shndërruar Zyrën e Presidencës në një nëndegë të z. Kurtit", ka shkruar Nushi në llogarinë e vet në "Facebook".

Të shtunën ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, përmes një adresimi në "Facebook" ka kritikuar KQZ-në në lidhje me veprimet e fundit. "Në rast se ballafaqohemi sërish me situata të tilla sikur ajo e djeshmja, ku abuzohet me KQZ-në si institucion i pavarur për të shtyrë përpara agjenda partiake si dhe forum ku ushtrohet presion mbi shërbyesit civilë do të detyrohem t'i ndërmarrë të gjitha masat për mbrojtjen e integritetit të KQZ-së dhe këtij procesi zgjedhor, ashtu siç e parasheh Ligji për Zgjedhjet dhe ashtu siç më detyron Kushtetuta e vendit", ka thënë ajo.

## LV-ja, AAK-ja dhe Nisma ankohen në PZAP

Lëvizja Vetëvendosje, AAK-ja dhe Nisma kanë dorëzuar ankesat në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për moscertifikim të listave të tyre zgjedhore nga KQZ-ja. "Lëvizja Vetëvendosje brenda afatit ligjor ka dorëzuar ankesë pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa kundër vendimit të djeshëm të KQZ-së për moscertifikimin e listës sonë për deputetë në zgjedhjet e 14 shkurtit", është thënë në njoftimin e KQZ-së. PZAP-ja ka treguar se edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate dhe disa subjekte nga radhët e minoriteteve në Kosovë janë ankuar të shtunën në PZAP lidhur me moscertifikimin e subjektit dhe kandidatëve për deputetë.



FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI DEHARI

# Për deputet më propozuan shumë anëtarë dhe shokë nga Vetëvendosja, synojmë mbi 60 mandate

**Veprimtari i çështjes kombëtare dhe shkrimtari Avni Dehari, i cili është kandidat për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se i ka hyrë kësaj gare pas propozimit nga shumë anëtarë dhe shokë të tij nga kjo lëvizje. Dehari në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka deklaruar se ai nuk mund të mos besojë se përpjekja për t'ia pamundësuar Albin Kurtit që t'i prijë listës së kandidatëve në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka prapavijë politike. Pavarësisht kësaj, Dehari beson se LV-ja në këto zgjedhje do t'i fitojë më shumë se 60 mandate. "Përshtypja ime, edhe pse nuk është reprezentative në kuptimin statistikor, është se ky numër i mandateve, që Lëvizja Vetëvendosje do të fitojë në këto zgjedhje, është edhe më i madh se kaq", ka thënë Dehari**

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 JANAR - Veprimtari i çështjes kombëtare dhe shkrimtari Avni Dehari në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit është pjesë e listës e Lëvizjes Vetëvendosjes për deputet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se kush e ka shtyrë që të bëhet pjesë e garës zgjedhore për deputet. "Më propozuan shumë anëtarë dhe shokë nga Lëvizja Vetëvendosje! Ata me përkushtim janë përcaktuar ta bëjnë ndryshimin e madh që qytetarët e Kosovës të kenë liri dhe jetë më të mirë, për të cilën kanë luftuar me mijëra luftëtarë dhe shumë prej tyre kanë rënë dëshmorë", ka treguar Dehari, duke shtuar se që nga themelimi ka mbështetur angazhimin dhe programin e Lëvizjes Vetëvendosje. "Si anëtar i këtij subjekti propozimin që të jem kandidat për deputet e kam vlerësuar si një obligim politik dhe moral që vështirë mund të refuzohet. Sidomos kur merren parasysh vullneti dhe gatishmëria e paparë e qytetarëve të Kosovës që ta mbështesin Lëvizjen Vetëvendosjepër ndryshime të mëdha dhe pritjet e tyre për jetë më të denjë se deri më tash, me shumë të drejtë, të bëjnë të mos e kursesh angazhimin deri në fund. Fundja, unë jam ky që jam falë shokëve atdhetarë, prandaj nuk refuzova kërkesën e tyre", ka thënë Dehari.

Duke folur për moscertifikimin e listës së Vetëvendosjes nga ana e KQZ-së, Dehari ka thënë se ai nuk mund të mos besojë se përpjekja për t'ia pamundësuar Albin Kurtit që t'i prijë listës së kandidatëve në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka prapavijë politike. "Kjo është dëshmuar edhe në të kaluarën e afërt. Të gjithë jemi dëshmitarë se lufta për ta penguar, për ta rrëzuar atë nga qeverisja, është zhvilluar në rrethana të papranueshme demokratike, ka qenë e padrejtë, aspak njerëzore dhe tepër e egër", është shprehur Dehari. Ai ka theksuar se "keqpërdorimi i Kushtetutës dhe i ligjit ndodh sidomos kur forcohet fuqia politike e Lëvizjes Vetëvendosje në krye të së cilës qëndron ky personalitet politik që ka kohë që gëzon mbështetjen më të madhe në popull".

Dehari beson se LV-ja në këto zgjedhje do t'i fitojë më shumë se 60 mandate. "Përshtypja ime, edhe pse nuk është reprezentative në kuptimin statistikor, është se ky numër i mandateve, që Lëvizja Vetëvendosje do të fitojë në këto zgjedhje, është edhe më i madh se kaq", ka theksuar ai. Dehari në këtë intervistë thotë se vendin e presin punë të shumta e të mëdha dhe tepër të rëndësishme për shtetësinë e Kosovës dhe për rendin e saj demokratik. "Lëvizja Vetëvendosje që nga themelimi i saj seriozisht i ka përvjelë krahët t'i hyjë punës me përkushtim. Në kuptimin metaforik para nesh ka një oqean me punë. Punë, punë dhe vetëm punë, me nder, me përgjegjësi, me disiplinë dhe me dashuri për Atdheun!", ka theksuar Dehari.

**"Epoka e re":** *Z. Dehari, kush ju propozoi dhe pse pranuat të jeni kandidat për deputet në listën e Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjet e 14 shkurtit?*

**Dehari:** Më propozuan shumë anëtarë dhe shokë nga Lëvizja Vetëvendosje. Ata me përkushtim janë përcaktuar ta bëjnë ndryshimin e madh që qytetarët e Kosovës të kenë liri dhe jetë më të mirë, për të cilën kanë luftuar me mijëra luftëtarë dhe shumë prej tyre kanë rënë dëshmorë. Për këtë qëllim, që nga themelimi i Lëvizjes Vetëvendosje e deri më tash ata që më propozuan nuk kanë kursyer as mundin, as djersën, as sakrificat, në shumë raste edhe më të mëdha sesa janë pritur. Me pjesëmarrjen e tyre në jetën parlamentare, në këto rrethana jo të lehta politike në të cilat gjendemi, ata kanë vendosur t'i forcojnë themelet e shtetit tonë me ndryshimet pozitive që synojnë t'i bëjnë në të gjitha poret e jetës shoqërore. Kjo kërkon dije, mund dhe përkushtim të madh. Për këtë ata kanë edhe vullnetin, edhe dijen, edhe përkushtimin.

Që nga themelimi i Lëvizjes Vetëvendosje unë kam mbështetur angazhimin dhe programin e saj. Si anëtar i këtij subjekti, propozimin që të jem kandidat për deputet e kam vlerësuar si një obligim politik dhe moral që vështirë mund të refuzohet. Sidomos kur merren parasysh vullneti dhe gatishmëria e paparë e qytetarëve të Kosovës që ta →

mbështesin Lëvizjen Vetëvendosje për ndryshime të mëdha dhe pritjet e tyre për jetë më të denjë se deri më tash, me shumë të drejtë, të bëjnë të mos e kursesh angazhimin deri në fund. Fundja, unë jam ky që jam falë shokëve atdhetarë, prandaj nuk refuzova kërkesën e tyre.

**"Epoka e re":** *Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar se 47 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në mesin e tyre është edhe lideri i LV-së, Albin Kurti. Si e keni parë ju këtë vendim?*

**Dehari:** Kjo nuk është e saktë. Sa kam kuptuar unë nga mediat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka konstatuar këtë që po thoni ju. KGjK-ja e ka njoftuar KQZ-në për të gjithë personat në listat e kandidatëve që kanë çfarëdo vendimi përfundimtar të një gjykate. Ajo i është përgjigjur KQZ-së në pyetjen e shtruar për listat dhe për kandidatët me të dhënat që ka. Sa kuptoj unë nga drejtësia ligjore, KGjK-ja as nuk vendos t'ia ndalojë ose t'ia lejojë ndokujt të drejtën për të qenë deputet. Prandaj, kjo nuk ka të bëjë fare me ndalimin e kandidimit të Albin Kurtit ose të të tjerëve. Unë nuk mund të mos besoj se përpjekja për t'ia pamundësuar Albin Kurtit që t'i prijë listës së kandidatëve në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka prapavijë politike. Kjo është dëshmuar edhe në të kaluarën e afërt. Të gjithë jemi dëshmitarë se lufta për ta penguar, për ta rrëzuar atë nga qeverisja është zhvilluar në rrethana të papranueshme demokratike, ka qenë e padrejtë, aspak njerëzore dhe tepër e egër. Keqpërdorimi i Kushtetutës dhe i ligjit ndodh sidomos kur forcohet fuqia politike e Lëvizjes Vetëvendosje në krye të së cilës qëndron ky personalitet politik që ka kohë që gëzon mbështetjen më të madhe në popull. Mendoj, dhe e them me bindje të plotë, se ata që e kanë nëpërkëmbur deri më tash vullnetin e popullit, që e kanë keqpërdorur qeverisjen në dëm të qytetarëve të Kosovës, me çdo kusht përpiqen ta ruajnë pushtetin që u ka sjellë përfitime të mëdha politike dhe ekonomike të pamerituara. Albin Kurti në këtë pikëvështrim u pengon. Përcaktimet programore të Lëvizjes Vetëvendosje, që ai i përfaqëson, nuk do të lejojnë më që të nëpërkëmbet vullneti i qytetarëve.



**"Epoka e re":** *Tanimë janë dalë disa sondazhe që Vetëvendosjen e radhitin subjektin e parë në këto zgjedhje. Nga zyrtarët e saj po thuhet se në zgjedhjet e 14 shkurtit LV-ja do t'i fitojë mbi 60 mandate.*

**Dehari:** Unë nuk jam as njohës, as analist i opinionit publik. Unë mund të flas vetëm për përshtypjet e mia personale nga kontaktet e përditshme gjithandej me qytetarët e Kosovës e më gjerë. Premtimet programore që ofron Lëvizja Vetëvendosje ngjallin shpresë të madhe se korrupsioni, kriminaliteti, keqqeverisja, që janë bërë kancer në themelet e shtetit tonë, do të marrin fund përgjithmonë. Kjo është dëshmuar edhe në qeverisjen jetëshkurtër të kësaj partie. Për atë pak kohë, sa ajo ishte në pushtet, qytetarët janë bindur se edhe në Kosovë gjërat mund të kthehen për së mbari. Qytetari ynë meriton jetë më të mirë në vendin e tij, jo të tretet nëpër botë për ta siguruar kafshatën e hidhur të bukës. Nëse dje ka qenë detyrë e shenjtë të luftosh dhe ta japësh jetën për lirinë e Kosovës, sot është detyrë po aq e shenjtë të punosh me nder e përkushtim për ndërtimin, për forcimin dhe për ruajtjen e shtetësisë së saj. Përshtypja ime, edhe pse nuk është reprezentative në kuptimin statistikor, është se ky numër i mandateve, që Lëvizja Vetëvendosje do të fitojë në këto zgjedhje, është edhe më i madh se kaq.

**"Epoka e re":** *Po nëse LV-ja nuk arrin këtë numër të deputetëve dhe duhet ndihma edhe e një partie tjetër për të bashkëqeverisur, ju personalisht me cilin subjekt politik preferoni që LV-ja të lidhë koalicion paszgjedhor. Me LDK-në u provua. Sa janë gjasat me PDK-në?*

**Dehari:** Në këtë drejtim nuk kam ndonjë mendim të kristalizuar. Parimisht nuk dua të përgjigjem në pyetjet e tilla hipotetike. Besoj shumë se do të jetësohen pritjet për një qeverisje të qëndrueshme dhe të suksesshme. Kur të shtrohet nevoja për koalicion, kjo çështje do të zgjidhet si është më së miri. Rrethanat që do të krijohen nuk do të mundësojnë të ndodhë si në zgjedhjet e shkuara. Në fund të fundit, kjo është detyrë e organeve më të larta të Lëvizjes Vetëvendosje Unë nuk jam pjesë e tyre, prandaj nuk dua as të paragjykoj, as nuk dua ta marr rolin që nuk më takon.

**"Epoka e re":** *LV-ja ka arritur një marrëveshje me Vjosa Osmanin që, sipas kësaj marrëveshje, asaj i është premtuar posti i presidentit. Në anën tjetër kemi edhe kryetarin e AAK-së i cili pretendon këtë pozitë, dhe kemi propozime që për postin e presidentit të jetë edhe Murat Jashari. Ju, mes këtyre tri personaliteteve, kënd kishit zgjedhur për president?*

**Dehari:** Për mua, si qytetar i këtij vendi, është me rëndësi të kemi për president një personalitet me vlera njerëzore dhe politike, që çmohet nga të gjithë. Shteti ynë ka nevojë për një personalitet të pranueshëm nga të gjithë, siç thuhet shpesh dhe me shumë të drejtë. Pa mëdyshje do të propozohet për president një njeri që do t'i ketë këto vlera. Meqë Lëvizja Vetëvendosje në vazhdimësi ka synuar një personalitet të tillë për president të vendit, si qytetar dhe si anëtar i saj, unë do ta mbështes. Unë jam kandidat për deputet i Lëvizjes me bindje, me ndërgjegje dhe me besim të plotë në organet e saj.

**"Epoka e re":** *Cili është vlerësimi juaj në përgjithësi për zhvillimet në Kosovë, qoftë në aspektin politik, ekonomik dhe social, dhe si i shihni proceset pas zgjedhjeve të 14 shkurtit?*

**Dehari:** Na presin punë të shumta e të mëdha dhe tepër të rëndësishme për shtetësinë e Kosovës dhe për rendin e saj demokratik. Vetëm, a je ai që punon! Punë ka shumë dhe për të gjithë. Lëvizja Vetëvendosje që nga themelimi i saj seriozisht i ka përvjelë krahët t'i hyjë punës me përkushtim. Në kuptimin metaforik, para nesh ka një oqean me punë! Punë, punë dhe vetëm punë, me nder, me përgjegjësi, me disiplinë dhe me dashuri për atdheun!

# Nisma paraqet kandidatët për deputetë, Limaj thotë se ata do të jenë zëri i UÇK-së në Kuvend

**Prishtinë, 24 janar (ER)** - Nisma Socialdemokrate ka bërë paraqitjen e kandidatëve për deputetë në Kuvend të Kosovës për zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë takim, para kandidatëve për deputetë ka folur kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili ka thënë se është nder i madh për secilin kandidat të Nismës të jetë kandidat për Kuvendin e Republikës së Kosovës. "Nuk ka gjë më të rëndësishme për ne sesa të dalim të takojmë njerëz e ta kërkojmë mbështetjen e bashkëluftëtarëve për realizimin e ëndrrës sonë të madhe, për një Kosovë të lirë e me vlera", ka thënë Limaj.







Ai ka kërkuar nga të pranishmit që të mos bien pre e propagandës ditore, të atyre që kanë për mision shkatërrimin e humbjen e vlerës së çdo hapi pozitiv që është bërë në vendin tonë. "Objektivi ynë është që ne si Nismë të luftojmë që të fitojë kauza jonë. Angazhimi ynë ditor është që të kemi një zë të fuqishëm për këtë kauzë, sepse me fitoren e kauzës sonë nuk fiton veç aktivisti ynë, por fiton çdo qytetar i Kosovës, dhe ky është dallimi ynë me të tjerët", ka thënë Limaj.

Lideri i Nismës, po ashtu, ka thënë se ne kemi dallime esenciale me të tjerët, sepse për ne trashëgimia jonë çlirimtare është themeli i shtetit të Kosovës. "Dje në vijat e frontit mbroheshin me luftë liria, dinjiteti, krenaria dhe emri i UÇK-së, të cilat vlera u sulmuan nga forcat serbe, ndërsa sot, liria dhe UÇK-ja po sulmohen në mendjet dhe zemrat e qytetarëve tanë, prandaj ne jemi ata që po angazhohemi fuqishëm që mos të lejojmë të ndodhë një sulm i tillë që dëmton vendin dhe vlerat tona", ka thënë Limaj.

Më tutje, Limaj ka thënë se "angazhimi ynë është për mbrojtjen e vlerave më sublime të historisë sonë, për të cilat sot përfaqësuesit e kësaj historie janë në Hagë, ndërsa të tjerët na flasin për rimëkëmbje, pra ata flasin kështu sepse ata e kanë humbur rrugën, flasin kështu sepse ata janë rritur politikisht me kalkulime". Limaj ka bërë thirrje për t'u bashkuar për betejën e radhës, "që më 14 shkurt ta shijojmë fitoren dhe mundësinë për të vazhduar në shërbim të vendit". "Ne besojmë në angazhimin tonë për të shkuar tek objektivi ynë, sepse kjo është rruga jonë e drejtë për ta mbrojtur e për t'i shërbyer vendit. Çdo djalë e vajzë që ka pas të veshur uniformën e UÇK-së, sot fytyra e tyre është në Hagë, sepse atje sot janë historia jonë, prandaj duhet të ngritemi fuqishëm, në mënyrë që vlerat tona kombëtare t'i mbrojmë me një zë sa më të fuqishëm në Kuvend", ka thënë Limaj.

Në prezantimin e kandidatëve për deputetë ka folur edhe sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi. Sherifi ka thënë se është jetike që t'i mobilizojmë forcat tona, që fryma, programi dhe themelet që ia kanë vënë kësaj partie, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj t'i çojmë përpara dhe që zëri ynë të dëgjohet sa më fuqishëm në Kuvend. "Jemi ne këtu dhe mijëra mbështetës tanë anekënd Kosovës, që do ta përcaktojnë fatin e Nismës në zgjedhjet e 14 shkurtit dhe askush tjetër, prandaj le të vazhdojmë të shkojmë derë me derë te çdo qytetar i Kosovës dhe të kërkojmë mbështetje për Nismën Socialdemokrate, që të jetë pjesë e legjislaturës së ardhshme të Kuvendit të Kosovës", ka thënë Sherifi.

# Gjashtë të vdekur, 222 të shëruar dhe 392 raste të reja me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë ndërruar jetë gjashtë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 392 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 222 persona. Duke iu referuar gjendjes së përgjithshme me Covid, IKShPK-ja ka kërkuar nga qytetarët që t'i respektojnë masat kundër Covidit. Në këtë kontekst, IKShPK-ja i bërë thirrje policisë dhe inspektorateve që t'i ndërmarrin të gjitha ndërmarrjet për zbatimin e masave kundër Covidit




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë kanë vdekur gjashtë persona të cilët kanë qenë të infektuar me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 392 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 222 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1618 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 392 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 6 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan 1 rast (72 vjeç), Kamenicë 1 rast (57 vjeç), Mitrovicë 1 rast (83 vjeç), Prishtinë 1 rast (73 vjeç), Viti 1 rast (51 vjeç), Vushtrri 1 rast (62 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 58 088 raste nga 219 760 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 456 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 222 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 50 953 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 5 679", ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se Prishtina vazhdon të prijë më numrin më të madh të rasteve të reja me Covid.

"Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 142 raste, Podujevë 34 raste, Prizren 34 raste, Mitrovicë 29 raste, Ferizaj 26 raste, Gjilan 19 raste, Gjakovë 15 raste, Lipjan 15 raste, Vushtrri 11 raste, Fushë-Kosovë 10 raste, Skenderaj 10 raste, Obiliq 7 raste, Drenas 5 raste, Klinë 5 raste, Rahovec 5 raste, Viti 5 raste, Deçan 4 raste, Kaçanik 4 raste, Kamenicë 3 raste, Shtime 3 raste, Malishevë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Dragash, Kllokot, Pejë dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Më tutje, IKShPK-ja ka kërkuar nga qytetarët që t'i respektojnë masat kundër Covidit. "Duke pasur parasysh vlerësimin e situatës aktuale me Covid-19, sot kemi regjistruar 392 raste pozitive dhe rritje të rasteve të hospitalizuara. Mjekët në spitale po luftojnë kundër këtij virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale dhe njerëzore. Numri i rasteve pozitive vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19", ka njoftuar IKShPK-ja, duke i bërë thirrje policisë dhe inspektorateve që t'i ndërmarrin të gjitha ndërmarrjet për zbatimin e masave kundër Covidit. "Në veçanti, bëjmë thirrje për zbatimin e rekomandimeve dhe respektimin e masave kufizuese për aktivitetet publike, përkatësisht kufizimeve për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike. Grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-COV-2 është i pranishëm në mesin tonë. Apelojmë tek institucionet përgjegjëse, përkatësisht Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse, që ta mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës", ka njoftuar IKShPK-ja.

# Hoxhaj e Ismaili premtojnë rregullimin dhe uljen e çmimeve të barnave në Kosovë

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i kësaj partie, Uran Ismaili, janë takuar të dielën me disa farmacistë të cilëve u kanë premtuar mbështetje, duke theksuar se dallimi i çmimeve të barnave po dëmton qytetarët e Kosovës. PDK-ja është duke insistuar për jetësimin e udhëzimit administrativ me anë të të cilit rregullohen çmimet e barnave. Madje, sipas kësaj partie, dy qeveritë e kaluara kanë dëmtuar shumë qytetarin e Kosovës, ndërkohë që kandidati për kryeministër Enver Hoxhaj, ka theksuar se do të trajtohet me prioritet sektori i farmacisë. "Këtu llogaritni mbështetje të plotë, po më vjen shumë mirë që ju keni qëndrimin unik, sikur që ne kemi qëndrimin unik që ta rikthejmë atë udhëzim administrativ. Për shkak të pandemisë një pjesë e madhe e qytetarëve kanë paguar shuma të mëdha të parave për t'u shëruar", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka treguar se duke qenë vetë i infektuar me Covid-19, e di mirë se sa i ka kushtuar terapia gjatë kohës së trajtimit për ta tejkaluar virusin. "Shuma është shumë e madhe, është e barabartë me rrogën time të deputetit. Dhe nëse paga ime shkon për ta tejkaluar Covid-19, imagjinoni dikë që është pensionist apo dikë që ka një pagë më të ulët", ka thënë Hoxhaj, duke i siguruar farmacistët se PDK-ja do ta ketë prioritet shëndetësinë. "Rregullimi më i thjeshtë është që të hapen vende të reja të punës në mënyrë specifike, në klinikë, në spitale rajonale, të përgjithshme, në qendra të mëdha të Kosovës. Prandaj, dua t'ju them që llogariteni në mbështetjen tonë të plotë", ka thënë Hoxhaj.

Ndërsa sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se sektori i farmacisë duhet të trajtohet me prioritet meqë, sipas tij, është lidhja në mes të qytetarit dhe barnave. "Ju e keni parë rastin me 'Remdesivir', një bari që kushtonte 20 euro, filloi të shitet në Kosovë 200 deri në 700 euro. Edhe në një kohë kur ai ka nevojë më së shumti, qeveritë e kaluara asnjëra nuk e ndali këtë abuzim që po i bëhet qytetarit. Edhe kush është adresa? Po jeni ju, se po mendojnë që ju jeni abuzuesit", ka thënë Ismaili. Më tutje, Ismaili ka theksuar se janë të vendosur që të mos lejojnë asnjë lloj abuzimi që për vjet të tëra u janë bërë qytetarëve.



# 14 shkurti, Kosova dhe liderët!



Shkruan:
Bedri ISLAMI

Një mik imi shumë i afërt dhe i mirë, më shkroi dhe më pyeste se çfarë mendoj për 14 shkurtin, Kosovën dhe liderët. Është një varg i Shekspirit, që në shqip mund të përligjet kështu: “Duke vështruar errësirën që shohin të verbërit”. Përgjithësisht në Kosovë - në Shqipërinë londineze, po ashtu, na mungon një klasë politike që nuk influencohet nga joshjet, as nga frikësimet; një klasë politike që ushtron me kryelartësi privilegjin për ta kritikuar administratën dhe që, pas një seance parlamentare, pasi ka thënë çfarë ka menduar dhe me forcë ka kërkuar zgjidhje, kthehet në këmbë nga salla parlamentare, e mbrojtur nga mirëbesimi i popullit. Deri tani në Kosovë shefi i një qeverie ka pasur fuqinë e një mbreti absolut, pa pasur maturinë që duhej të kishte një kryetitullar. Shumë gjëra kanë qenë të hallakatura, pa principe morale e kombëtare, të pakujdesshme dhe përfituese. Të gjithë kanë spekuluar me fjalën "popull", por tani pikërisht populli duhet të thotë "Mjaft"! Është e vështirë të qeverisësh një popull që del nga robërimi dhe është i përligjur padurimi i tij, pikërisht nga pritja e gjatë dhe shëmbëlltyra që ka njohur. Por, jo e pamundur. Për të pasur një shtet të qëndrueshëm, mbi gjithçka tjetër, duhet që personat që qeverisin të demonstrojnë kreativitet, guxim dhe lidership. Duhet që ata, pasi të jenë disa kohë liderë, të bëhen prijës, pasi ka një ndryshim të madh, të pakapshëm, mes liderit dhe prijësit. Lideri është i përveçëm, prijësi është i të gjithëve! Një shembull: Fehmi Lladrovci kurrë nuk ka qenë lideri i vetëm i një force politike, por ka qenë prijësi i të gjithëve! Askush nuk u nda prej tij pa e ndier veten më trim! Duhet të ketë qeveritarë të guximshëm, që të jenë në lartësinë e duhur, për t’u përballur me vështirësitë e paraqitura nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të veprojnë, jo për interesin e tyre vetjak, por për të mirën e përgjithshme. Të jenë qeveritarë që nuk kanë drojë nga dalja në popull, përkundrazi, ata të priten nga njerëzit për vlerat e tyre, të besohen dhe të shkohet pas tyre që, edhe pasi ata të largohen nga postet, për veprën e tyre të mbetet mirënjohja. Liderë që bëhen prijës dhe nuk kanë frikë të eksperimentojnë, të drejtojnë dhe mbi të gjitha… të pyesin, të dëgjojnë, të bëjnë drejtësi. Çdo komb në kohë krize evokon një mit kombëtar dhe figurën tradicionale të një heroi.

Për fat të keq ne kemi liderë në Kosovë, por jemi në pritje të një prijësi! Kam vënë re se jo pak herë djalli i kryengritjes merr pamjen e engjëllit të reformës! Unë jam kundër verbërisë politike, kundër nënshtrimit dhe jo rrallëherë ne kemi pasur verbëri dhe nënshtrim! E di se Albin Kurti do të jetë fituesi i zgjedhjeve të 14 shkurtit dhe shumë veta do të duan të jenë kumbarët e tij! Nëse nuk do të jetë në listën e kandidatëve për deputetë, Lëvizja Vetëvendosje do të ketë më shumë votues sepse, veç atyre që presin kthimin e tij në krye të qeverisë, shumë të lëkundur do të priren drejt tij, si shpagim për klasën e vjetër politike, që u plak aq shpejt, saqë duket sikur ka qeverisur një mijë vjet. Dhe ka qeverisur trupërisht! Mua, personalisht, nuk më pëlqen motoja e tij elektorale, "Krejt dhe drejt". Më saktë nuk më pëlqen pjesa e parë e saj, për dy arsye: e para, ma kujton thirrjen e bolshevikëve në vitin 1917, "Krejt pushteti sovjetëve", dhe Albin Kurti, sado i majtë të duket, ai, në fakt, është nacionalist i shkallës sipërore; dhe, e dyta, arti i bashkëqeverisjes është arti i së mundshmes. Kam shkruar dikur se është për t’u çuditur, por kombet jo rrallë kanë zgjedhur përgjithësisht si figura përdalluese individë që nuk u ngjajnë shumë. Pas luftës kjo ka ndodhur edhe në Kosovë. Tani është koha e fundit që të ketë një përafrim të shëmbëlltyrës së kombit me atë të liderit!

# Kandidaturat për president vështirësojnë arritjen e koalicioneve paszgjedhore

Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit për herë të parë, përkundër faktit që nuk garohet për postin e presidentit, janë shpallur dy kandidatura për të parin e shtetit. Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paraqitur i pari kandidaturën e tij për këtë post, ndërsa garës i ka hyrë edhe Vjosa Osmani, e cila aktualisht ushtron postin e presidentes. Pavarësisht se Kushtetuta e Kosovës thotë se presidenti përfaqëson unitetin e popullit dhe është jopartiak, tashmë është bërë pothuajse normale që të bëhet “pazar” me këtë post. Kjo është hera e parë që vendi është duke shkuar në zgjedhje, ndërsa qytetarëve është duke u “kërkuar që të votohet edhe për të parin e vendit”. Njohës të rrethanave politike kanë vlerësuar se partitë po përdorin këtë strategji me qëllim që ta rrisin “pazarin” e tyre negociues. Madje ka nga ata që kanë thënë se sjellja e partive politike për postin e presidentit është edhe joetike. Sipas tyre, zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit do të mund të anashkalonte kriza politike dhe institucionale me të cilat jo rrallëherë është përballur Kosova.

Albert Krasniqi nga Demokracia Plus ka thënë se posti i presidentit do ta vështirësojë edhe më shumë arritjen e koalicioneve qeveritare. “Kësaj radhe është pak më specifike sepse në të njëjtën kohë kërkohet nga Kuvendi ta zgjedhë edhe qeverinë edhe presidentin dhe kjo i ka mobilizuar partitë politike që të dalin edhe me kandidatët e tyre për president. Mirëpo, kjo do të ketë efekt negativ për shkak se presidenti nuk zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, por zgjidhet nga Kuvendi dhe e dyta, do ta vështirësojë arritjen e koalicioneve qeveritare për shkak se partitë politike do ta kenë si barrierë kur të negociojnë për shkak se do të insistojnë që kandidatët e tyre të jenë për president. Kështu, në situata kur ne zakonisht kemi ngërçe institucionale për themelimin e qeverisë, kësaj radhe mund të jenë edhe më të shprehura”, ka thënë Krasniqi. Sipas tij, të dy kandidatët për president janë duke garuar në këtë garë për ulëse në Kuvend. Ai ka thënë se partitë politike duhet të përmbahen nga propozimi i kandidatëve për president. “Edhe z. Haradinaj, edhe znj. Osmani janë duke garuar për ulësen e deputetit në Kuvend, dhe votat e qytetarëve të cilët i votojnë këta persona do të jenë vetëm për përfaqësimin e tyre në Kuvend… Kështu që do të ishte mirë që partitë politike të përmbahen sidomos nga propozimi i kandidatëve për president, për shkak se kjo kërkon një konsensus shumë të gjerë, duhen 2/3 e votave të deputetëve, të sigurohet kuorumi dhe do të kërkojë domosdoshmërisht negociata ndërmjet partive politike për të gjetur konsensus për personin e përshtatshëm. Dalja në publik me emra qysh tani për president po përdoret më shumë për arsye strategjike,



qoftë për ta rritur pazarin e tyre negociues, pastaj që të jenë më rezistentë dhe të kërkojnë kompromise më të mëdha nëse do të heqin dorë nga pozita e presidentit ose ta pamundësojnë arritjen e një marrëveshjeje”, është shprehur Krasniqi.

Ndërsa Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se posti i presidentit nuk duhet të vihet në shërbim të një partie. “E dimë që procedura për t’u bërë president është e përcaktuar me Kushtetutë, që duhet të paktën të ketë mbështetjen e 40 deputetëve në Kuvend për t’u kandiduar dhe më pas të ketë një kuorum prej 80 deputetësh në Kuvend për ta marrë votën për ose kundër për t’u bërë president. Ne kemi parë ne të kaluarën edhe presidentë të cilët kanë qenë partiakë, apo edhe presidenten Jahjaga që nuk ka pasur një afrim partiak. Ajo që mbetet e qartë është se çdo person që të nesërmen do të jetë president i vendit, duhet ta dijë që duhet të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve, të të gjitha partive politike dhe nuk mund ta përfaqësojë një parti politike të veçantë”, ka thënë ajo.

E për t’i shmangur krizat politike dhe institucionale që jo rrallëherë janë shkaktuar për shkak të këtij posti, Krasniqi ka thënë se do të ishte më mirë që i pari i vendit të zgjidhej drejtpërdrejt nga populli. “Mënyra sesi zgjidhet presidenti kërkohet që të zgjidhet nga deputetët e Kuvendit, të cilët i zgjedh qytetari dhe nuk kemi ende një proces të drejtpërdrejtë të zgjedhjes së presidentit. Ky pozicion është bërë pjesë e pazareve politike dhe na ka çuar në kriza politike dhe institucionale dhe, ndoshta, zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit do të mund të anashkalonte këto kriza politike dhe institucionale, të cilat jemi duke i parë në vazhdimësi”, ka thënë ajo. Se kandidatura e Ramush Haradinajt dhe Vjosa Osmanit për postin e presidentit është joetike, e ka thënë edhe njohësi i çështjeve politike, Rasim Alija. Sipas tij, po bëhet pazar nga ata njerëz që dikur kanë thënë se çështja e presidentit është vullnet i deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës. “Sjellja e subjekteve politike, aq më shumë e dy pretendentëve, sa joetike, është edhe një lloj risie në skenën politike të Kosovës, duke marrë parasysh që sistemi i zgjedhjes së presidentit në Kosovë varet prej Kuvendit, rrjedhimisht prej deputetëve që i fitojnë ato mandate, pastaj është në vullnetin e atyre deputetëve që të votojnë dhe ta zgjedhin një president. Duket se kandidimi i z. Haradinaj për postin e presidentit dhe moskandidimi i tij ose heqja dorë prej pozitës së kryeministrit është një taktikë e AAK-së që në njërën anë të arrijë ta forcojë figurën e z. Haradinaj si lider, të mos matet në aspektin e garës për kryeministër e njëkohësisht të arrijë të fitojë sa më shumë vota duke u thirrur në emër të një kandidature për president. Në anën tjetër, e kemi u. d. e presidentit, z. Vjosa, e cila po tenton që jashtë deklarimeve të saj, gjithmonë që çështja e zgjedhjes së presidentit i takon një legjislature të re që do të vijë. Ato parime janë shkelur dhe rrjedhimisht po bëhet pazar nga po këta që dikur kanë thënë se çështja e presidentit është vullnet i deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës. Pra, është njëfarë mishmashi në skenën politike”, ka thënë ai. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë pritet të mbahen më 14 shkurt. /ksp/

BISEDË ME EMRUSH UJKANIN PËR “EPOKËN E RE”

# Ujkani: Partitë politike duhet të kenë një pako të veçantë për investitorët e huaj



Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë se në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, Kosova duhet ta ketë edhe një pako të veçantë për tërheqjen e investitorëve të huaj. “Krahas planprogramit për rimëkëmbje ekonomike duhet ta kemi një ‘special window’ (dritare të veçantë) për tërheqjen e investitorëve dhe mbrojtjen e atyre ekzistuese, pasi janë duke u penguar që ta zhvillojnë aktivitetin ekonomik. Andaj, duhet të ketë planifikim të mirë që në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike të kemi edhe investitorë të rinj”, ka thënë Ujkani në këtë bisedë për “Epoka e re”. Ai ka theksuar se rritja e tarifave të energjisë elektrike është disfavorizuese për investitorët e huaj madje, sipas tij, ka kërcënime se për këtë mund të ketë largim të investitorëve

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 24 janar** - Deri më tani Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë paraqitur programet e tyre parazgjedhore sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. Një gjë të tillë ende nuk e ka bërë Lëvizja Vetëvendosje e cila drejtohet nga Albin Kurti. Lidhur me këtë, drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, në këtë bisedë për gazetën “Epoka e re” ka thënë se në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, Kosova duhet ta ketë një pako të veçantë sa i përket tërheqjes së investitorëve të huaj. Ai ka thënë se çfarëdo plani të rimëkëmbjes ekonomike që mund të kemi, nuk mund të konsiderohet i barasvlershëm me rimëkëmbjen ekonomike nëse, sipas tij, nuk “i kemi në fokus investitorët e huaj dhe mbajtjen e investitorëve aktualë”.

“Krahas planprogramit për rimëkëmbje ekonomike, duhet ta kemi një ‘special window’ (dritare të veçantë) për tërheqjen e investitorëve dhe mbrojtjen e atyre ekzistuese, pasi janë duke u penguar që ta zhvillojnë aktivitetin ekonomik. Andaj, duhet të ketë planifikim të mirë që në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike të kemi edhe investitorë të rinj. Jemi vendi që gjendemi në pozitën e fundit në rajon sa iu përket investitorëve të huaj dhe këto pengesa vetëm sa do ta rëndojnë situatën dhe pa marrë parasysh çfarë planprogrami ekonomik mund të kemi, një rast i tillë i largimit të investitorëve të huaj e themi në mënyrë hipotetike është shumëfish më shumë sesa çfarëdo plani që mund ta përgatitin partitë politike. Dhe kjo është mbi çdo planifikim tjetër”, ka thënë Ujkani. Po ashtu, ai ka theksuar se nga tani duhet të mendohet fundi apo pragu i kalimit të pandemisë, më pas shfaqet nevoja imediate e rimëkëmbjes ekonomike. “Do të duhej që në kuadër të planprogrameve të partive ekonomike, çështjen e tërheqjes së investitorëve të huaj ta trajtojnë si një dritare të posaçme që i targeton dhe bën përpjekje t’i tërheqë investitorët e huaj. Ne nuk duhet harrojmë një fakt se në momentin që të kalojë apo të jemi në prag që të kalojë pandemia Covid-19, do të krijohet një oportunitet i ri, e që nënkupton se duhet të kemi prioritet edhe tërheqjen e investitorëve të ri, pasi raportet të cilat ekzistojnë në mes të Perëndimit dhe Kinës janë duke e bërë të domosdoshme nevojën që të kërkohet mundësia edhe për tregje të reja. Rrjedhimisht, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të jemi të matur që krahas asaj që do të ndodhë në saje të rimëkëmbjeve ekonomike, të jemi edhe ne të përfshirë”, ka thënë ai.

Më tutje, Ujkani ka folur edhe për sfidat e investitorëve të huaj, me ç’rast ka theksuar se rritja e tarifave të energjisë elektrike është disfavorizuese për investitorët e huaj madje, sipas tij, ka kërcënime se për këtë mund të ketë largim të investitorëve. “Rritja e tarifave të energjisë elektrike është një ndër problemet e targetuara dhe shqetësuese për investitorët e huaj. Hyrja në fuqi e tarifave të reja do të jetë e papërballueshme për një pjesë të bizneseve dhe automatikisht s’po flasim më për atraksion, por po flasim për ato që janë pengesa dhe duhet që menjëherë të eliminohen. Po flas pas periudhës janar-maj, që mund të jenë tarifa të reja në kuadër të asaj që është komuniteti për energji në Vjenë dhe ajo që është energji e ripërtërirë, e që parashihet të ketë rritje. Nuk jam ekspert i kësaj fushe, por i di kërkesat e anëtarëve e që kërcënojnë edhe me largim nga vendi. Prandaj, kjo është shqetësuese dhe do të duhej të ishte shqetësuese edhe për institucionet”, ka thënë Ujkani.

Ndërsa sa iu përket planprogrameve ekonomike të tri partive, LDK-së, PDK-së dhe AAK-së, Ujkani ka thënë se programet e rimëkëmbjes ekonomike, nuk duhet t’u ngjajnë skemave sociale. “Planet që i kanë prezantuar të tri partitë politike deri më tani, LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja, lidhur me zhvillimin ekonomik dhe rimëkëmbjen pas pandemisë, mendoj se ka nevojë të punohet më tepër dhe të jenë plane më të detajuara. Ka nevojë për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe duhet të ngërthehet jo vetëm ajo çfarë është mundësi ekonomike apo buxhet nacional i vendit tonë, por këtu duhet edhe të bëhen përpjekje që të shfrytëzohen mekanizma të ndryshëm financiarë, qoftë ata që janë nën ombrellën e Bashkimit Evropian, qoftë nga mekanizma të tjerë me qëllim që të ketë një përgatitje adekuate, në mënyrë që ajo çfarë trajton rimëkëmbja ekonomike mos të trajtohet si skemë sociale. Çfarë kemi parë deri më tani më shumë ka qenë një formë e tillë, e jo një qasje e cila e adreson në fundament atë që është rimëkëmbje ekonomike dhe rikthimin e sektorit privat aty ku ishte para një viti”, ka deklaruar Ujkani, duke shtuar se në kuadër të ndërrimit të shpeshtë të qeverive, nuk kishte vendimmarrje efektive.

“Prandaj, programet e këtyre partive nuk është që kanë qenë shumë transparente. Programi i LDK-së vijon nga aty ku e kanë lënë vetë, pra nga dhjetori i vitit që lamë pas, por mendoj se duhet të ketë një transparencë më të madhe. Ne urojmë se cilado qeveri që vjen ta ketë guximin që të marrë vendime të leverdishme për bizneset dhe t’i shtyjë përpara proceset zhvillimore. Në vitin që lamë pas kishim tri lloje të qeverisë: atë të Haradinajt, të Kurtit dhe të Hotit, dhe e dini shumë mirë se s’kishte vendimmarrje efektive gjatë asaj periudhe, gjë që ka lënë shumëçka për t’u dëshiruar”, ka thënë Ujkani.

# LV-ja dhe LDK-ja e mendojnë rikthimin e reciprocitetit me Serbinë

PRISHTINË, 24 JANAR - Vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po vlerësohet si i paalternativë edhe pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Por kësaj radhe partitë politike e shohin si opsion edhe rikthimin e reciprocitetit ndaj Serbisë. Për dallim nga e kaluara, kur vetëm Lëvizja Vetëvendosje insistonte në këtë masë, tashmë zëra të tillë po dëgjohen edhe në LDK. Ndërsa në partinë e Ramush Haradinajt kërkojnë përfshirjen e sërishme të ShBA-së për arritjen e një marrëveshje finale me Serbinë që përfshinë njohjen reciproke.
Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, është shprehur i vendosur se marrëdhëniet me Serbinë pas zgjedhjeve do të ndërtohen vetëm mbi bazën e reciprocitetit. "Marrëdhëniet me Serbinë do të ndërtohen mbi reciprocitet, madje mbi bazën e së kaluarës së afërt e cila ende nuk është mbyllur. Gjithçka duhet të nisë me dokumentimin dhe adresimin e dëmeve të luftës, me evidentimin dhe gjetjet e personave të zhdukur dhe ndjekjen e dënimit të kriminelëve të luftës", ka thënë Kurti në mbledhjen e fundit të Këshillit të Përgjithshëm të LV-së. Ani pse para shtatë muajsh LDK-ja si partia kryesore në qeveri largoi masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, tashmë kjo ide po shihet si një ndër opsionet më reale ndaj shtetit fqinj. Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, njëherësh kandidati për deputet nga kjo parti, Faton Bislimi, ka thënë për "Kosovapress" se në vazhdimësi LDK-ja ka pasur qasje proaktive për dialogun me Serbinë por, sipas tij, reciprociteti mund të shfrytëzohet si instrument për t'i arritur qëllimet e caktuara. "LDK-ja në vazhdimësi ka pasur qasje proaktive të dialogut. Ne s'kemi pritur të bëhemi vetëm instrument i pjesëmarrjes në dialog, por në çdo aspekt dhe në koordinim të ngushtë me partnerët, veçanërisht ShBA-në, jemi munduar që procesin e dialogut ta kthejmë në një fazë përmbyllëse të tij dhe rezulton me njohje të dyanshme në mënyrë që çështja e marrëdhënieve tona me fqinjët tanë të rregullohet një herë e përgjithmonë… reciprociteti është politikë që gjendet në tavolinën e opsioneve dhe mund të shfrytëzohet si instrument për t'i arritur qëllimet e caktuara. Unë besoj se LDK-ja ka treguar gatishmërinë e saj që çdo mjet demokratik ta lë të hapur si mundësi e arritjes së qëllimeve të caktuara politike. Këtë rast edhe me Serbinë, pse jo. Ne e kemi parë dhe vazhdojmë ta shohim edhe reciprocitetin në kuadër të këtyre mjeteve politike", ka thënë Bislimi. Ndërsa nënkryetari i AAK-së,



Ahmet Isufi, ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të vazhdojë, me njohjen reciproke si temë të vetme në tavolinë. "Ne dialogun e shohim duke qenë në tavolinë ShBA-ja si partnerja dhe mikja e përjetshme e Kosovës, ndërsa të tjerët do t'i shohim si partnerë që mundësojnë një dialog të mirëfilltë duke pasur parasysh gjithmonë zgjidhjen finale që është njohja e Kosovës nga ana e Serbisë. Temat e tjera mund të diskutohen pas njohjes, por konsiderojmë se njohja është tema e cila duhet të jetë në tavolinë", ka thënë ai. "Kosovapress" ka provuar të marrë një qëndrim për dialogun edhe nga PDK-ja, mirëpo zyrtarë të saj nuk kanë qenë të qasshëm për t'u deklaruar rreth kësaj teme. Në anën tjetër, ligjëruesi i shkencave politike në Universitetin e Prishtinës, Dorajet Imeri, dialogun me Serbinë nuk e sheh si temë që pritet të hapet shpejt pas zgjedhjeve në Kosovë. "Kjo është një temë shumë e rëndësishme, varet nga mënyra si do të ndërtohen institucionet e Republikës dhe përbërja e tyre në periudhën e pas zgjedhjeve. Si temë mund të riaktualizohet edhe për shkak të faktorit ndërkombëtar, por kjo varet edhe nga përbërja që do të ketë Qeveria e Kosovës dhe nga përbërja e institucioneve të tjera të Republikës. Prandaj për këtë arsye vlerësoj se tash për tash partitë politike nuk kanë ndonjë fokus aty dhe si temë nuk është e hapur dhe nuk pritet të hapet shpejt", ka thënë Imeri.
Vitin e kaluar janë zhvilluar një sërë takimesh në Bruksel e Uashington me qëllim të arritjes së marrëveshjes finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, mirëpo një gjë e tillë nuk është arritur përveç një marrëveshje zotimesh ndërmjet dy shteteve në Shtëpinë e Bardhë, e cila ende nuk ka filluar të zbatohet. Ndërkohë prej muajit shtator të vitit të kaluar liderët institucionalë të dy shteteve nuk u takuan, pas kërkesës së palës serbe për ta hapur temën e themelimit të Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, e cila në mënyrë kategorike është refuzuar nga Kosova.

# Paratë nga diaspora mbajnë 'gjallë' ekonominë

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ismail Rrustaj nga Komuna e Klinës, i cili jeton në Prishtinë, që tre vjet me radhë pranon para nga djali 21-vjeçar që jeton në Itali. Ai thotë se gjatë vitit të kaluar djali i ka dërguar më shumë para për shkak të gjendjes së krijuar në Kosovë nga pandemia e koronavirusit. Rrustaj, mbi të 50-tat, ka edhe tre fëmijë të tjerë. Dy vajzat dhe një djalë kanë të përfunduar fakultete të ndryshme në Universitetin e Prishtinës por, siç thotë ai, nuk kanë ndonjë punë të qëndrueshme. Djali që ka përfunduar Fakultetin Juridik, punon kamerier në një restorant, kurse dy vajzat në qendra tregtare. Me gjithë faktin që në familje marrin tri paga në muaj, Rrustaj thotë se po mos të ishte ndihma financiare nga djali që jeton në Itali, nuk do të arrinte t'i mbulonte shpenzimet e nevojshme për jetë. "Djali im është 21 vjeç. Çdo muaj më dërgon nga 500 deri në 1 000 euro. Mos të ishte djali jashtë Kosovës, nuk e di se si do mund të jetoja. Me paratë që dërgon, paguaj qiranë, rrymën, obligimet komunale, ushqimin etj", ka thënë Rrustaj për "Radion Evropa



e Lirë".
Rrustaj jeton në një banesë me qira në një nga lagjet e Prishtinës. Nga fshati i lindjes ai u shpërngul në kryeqytet për shkak të studimeve të fëmijëve. Por, me pagat e fëmijëve që punojnë në sektorin privat në Kosovë, ai thotë se nuk do të kishin mundësi ta përballonin jetesën në Prishtinë. "Në Prishtinë nuk do të kishim mundësi të jetonim me pagat e fëmijëve. Në fshat po, ia kishim dalë disi", ka thënë Rrustaj.
Jo vetëm djali i Ismail Rrustajt ka dërguar mjete në Kosovë. Vlera e përgjithshme e parave të qytetarëve me prejardhje nga Kosova që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, nga muaji janar deri në muajin nëntor të vitit të kaluar ka arritur rreth 900 milionë euro. Vlerat më të larta, sipas Bankës Qendrore të Republikës se Kosovës, kanë qenë në muajin maj 104 milionë euro dhe në muajin tetor të vitit 2020, 99.4 milionë euro. Kurse në vitin 2019 shuma e remitencave ka qenë 851 milionë euro. Lirim Krasniqi, hulumtues dhe analist i politikave në organizatën "Germin", organizatë kjo që merret kryesisht me çështje të diasporës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se remitencat përgjatë viteve kanë pasur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, duke nxitur rritjen ekonomike dhe duke siguruar të ardhura shtesë për familjet me të ardhura më të vogla. "Këto mjete luajnë një element të rëndësishëm të mirëmbajtjes së ekonomisë së Kosovës, por edhe ruajtjes së paqes sociale, pasi remitencat përbëjnë 15 për qind të Bruto Produktit Vendor. Përveç remitencave, diaspora dërgon para edhe përmes kanaleve të tjera joformale", ka thënë Krasniqi. Ai ka bërë me dije se shumica e mjeteve financiare të dërguara nga qytetarët e Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të botës shpenzohen për konsum. "Fatkeqësia e kësaj është se këto mjete prapë dalin jashtë Kosovës, pasi shumica e produkteve të konsumit ditor importohen në Kosovë nga shtete të ndryshme", ka thënë ai.
Përveç remitencave, qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës kanë dërguar mjete edhe në buxhetin e Kosovës në mënyrë që ta ndihmojnë Qeverinë e Kosovës për ta luftuar pandeminë Covid-19. Mbi 717 mijë euro janë grumbulluar nga ndihmat e ardhura nga diaspora, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" drejtori i Thesarit të Kosovës, Ahmet Ismaili. "Nga këto mjete, 667 mijë euro janë nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës, kurse mbi 50 mijë euro janë nga qytetarët brenda vendit", ka thënë ai. Deri më tani 511 mijë euro janë alokuar në Fondin për Menaxhimin e Covid-19 të Ministrisë së Shëndetësisë, në kategorinë e shpenzimeve kapitale, kurse 206 mijë euro të tjera janë bartur në buxhetin për vitin 2021, të cilat, thotë Ismaili, do të shpenzohen vetëm për menaxhimin e pandemisë. Ndihma nga diaspora ka ardhur pas thirrjes që ua ka bërë qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, ish-kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 12 prill të vitit të kaluar, vetëm një muaj pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus. Po gjatë vitit të kaluar, kur në Kosovë ishin në fuqi masat kufizuese të lëvizjes, qytetarë nga diaspora, përmes aksioneve të ndryshme, kanë ndihmuar me pako ushqimore familjet me kushte të rënda ekonomike, njofton organizata "Germin", kurse në institucionet shëndetësore të Kosovës kanë sjellë 15 mijë teste dhe gjysmë milioni maska për qytetarët, si dhe veshje mbrojtëse kundër Covidit.

# ‘Kosovo for dummies’ hapi Festivalin ‘Talia e Flakës’

GJILAN, 24 JANAR (ER) - Teatri i Qytetit i Gjilanit, me shfaqjen premierë “Kosovo for dummies”, të autorit Jeton Neziraj e me regji të Blerta Rrustemi-Neziraj, ka hapur Festivalin e Dramës Origjinale Shqipe “Talia e Flakës”, një ndër shtyllat kryesore të manifestimit kulturor kombëtar “Flaka e Janarit 2021” që mbahet në nderim të heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të rënë nëpër historinë tonë të lavdishme për liri e pavarësi.
Festivalin “Talia e Flakës” e ka shpallur të hapur Deniza Limani, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, e cila, në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar të gjithë ata që janë angazhuar për këtë festival, për të gjitha ato pesë shfaqje që do të vijnë para publikut si pjesë e këtij festivali. Duke iu dëshiruar mirëseardhje të pranishmëve në sallë, ajo ka thënë se ky teatër për çdo muaj organizon program të mirëfilltë. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se ndihet krenare me artistët tanë dhe me “ata që janë nga Gjilani e që po na bëjnë krenarë me sukseset e tyre në Kosovë e botë”.
Ndërsa drejtori i Teatrit të Qytetit të Gjilanit, Erson Zymberi, ka thënë se për shkak të pandemisë dhe domosdoshmërisë së respektimit të rekomandimeve të IKShPK-së dhe respektimit të masave anti-Covid, numri i spektatorëve është i kufizuar. Ai ka thënë se kufizimin e këtij numri e ka përjetuar me dhimbje “sepse ky teatër, kjo sallë, kjo hapësirë, është mësuar që në festivale të tilla të jetë e stërmbushur”.
Përndryshe, në natën e parë është dhënë shfaqja nikoqire “Kosovo for dummies”, një prodhim premierë i Teatrit të Gjilanit, që rrëfen historinë e një vajze të re, Antigonës nga Kosova, një histori kjo sa qesharake aq edhe absurde



pasi ajo përballet me kërkesa të pakuptimta të autoriteteve zvicerane, për dokumentacione të llojllojshme, duke përfshirë këtu edhe dokumentin me të cilën do të dëshmonte se ajo nuk është rinoqeront, vetëm e vetëm që t’i refuzohej një të huaji, në këtë rast një kosovareje, lejeqëndrimi në Zvicër.
Kjo shfaqje mund të shihet edhe si një ngacmim që bëhet përmes artit, të atyre që janë përgjegjës që duhet të merren me të drejtat e qytetarëve të tyre, me fokus të veçantë me çështjen e lëvizjes së lirë të kosovarëve dhe trajtimin që iu bëhet atyre në shtetet e Evropës, aty ku ata ia mësyjnë si emigrantë.
Në shfaqje luajnë: Tringa Hasani, Aurita Agushi, Kushtrim Qerimi, Ernest Zymberi, Gani Rrahmani, Avni Shkodra, Safete Mustafa.
Festivali i Dramës Origjinale Shqipe “Talia e Flakës” do ta vazhdojë rrugëtimin me shfaqjen e natës së dytë (24 janar, ora 18:00), që vjen prodhim i Teatrit “Muharrem Qena” nga Mitrovica. Është kjo shfaqja “Thyerja”, e autorit Abdyl Bunjaku e me regji të Agim Selimit.
Kujtojmë se në natën e fundit përmbyllëse të edicionit të sivjetmë të “Talia e Flakës 2021” para publikut artdashës gjilanas, më 27 janar do të paraqitet Teatri Kombëtar i Prishtinës me shfaqjen e punuar nga regjisori Erson Zymberi, sipas tekstit të Beqir Musliut, “Të vdekurit mbajnë zi për atdheun”.

# Komuna e Kamenicës pranon donacion 100 bombola për shuarjen e zjarrit dhe disa helmeta




KAMENICË, 24 JANAR (ER) - Komuna e Kamenicës ka pranuar një donacion nga “Kosovatex Sh.P.K”, i cili përfshinë rreth 100 bombola për shuarjen e zjarrit dhe disa helmeta. Me këtë rast, kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, ka shprehur mirënjohje të thellë për secilin që po shpreh gatishmërinë për ta ndihmuar komunën në forma të ndryshme. “Sot pranuam një donacion nga ‘Kosovatex Sh.P.K’, e cila na dhuroi rreth 100 bombola dhe disa helmeta. E falënderoj për këtë bashkëpunim. Po ashtu, i shpreh mirënjohje edhe Luan Kastratit i cili mundësoi që ky donacion të arrij në Kamenicë”, ka thënë Kastrati.

# ‘Qatar Charity’ shpërndanë pako ushqimore, jorganë dhe batanije për 380 familje llapjane

PODUJEVË, 24 JANAR (ER) - Komuna e Podujevës ka njoftuar se organizata “Qatar Charity” ka dhuruar 380 pako ushqimore dhe po aq jorganë dhe batanije për familjet në nevojë të kësaj komune. Ky donacion vjen pas marrëveshjes së arritur ndërmjet kryetarit të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi me Mahmut Abbas, drejtor i përgjithshëm i organizatës “Qatar Charity”. Me këtë rast, kryetari Bulliqi ka falënderuar këtë organizatë për donacionin e dhuruar për familjet në nevojë, aq më tepër kur vjen në periudhë dimri dhe në kohë pandemie. Përveç donacionit, kryetari Bulliqi dhe drejtori Abbasi janë pajtuar për bashkëpunim edhe në fusha të tjera në interes të përbashkët.



# Rregullohet pjesa e dëmtuar e digës së liqenit në Mirushë

MALISHEVË, 24 JANAR (ER) - Ditët e fundit Komuna e Malishevës ka qenë e angazhuar për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në infrastrukturë. Në kuadër të këtyre intervenimeve është rregulluar edhe pjesa e dëmtuar e digës së liqenit në Mirushë, e cila ishte dëmtuar në dy herë gjatë vërshimeve. Punimet e kryera në këtë digë i kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina dhe kryetari i fshatit Mirushë, Urim Thaçi.
“Fillimisht është mbushur pjesa e dëmtuar e digës me material përkatës, më pas është vendosur rrjetë me armaturë dhe në fund është betonuar ajo pjesë e dëmtuar e digës. Sanimi i digës është një intervenim urgjent i kryer në të, me qëllim të krijimit të sigurisë së përgjithshme dhe mosdëmtim të mëtutjeshëm të saj, më pas do të bëhet edhe rregullimi i tërësishëm i saj, përfshirë edhe shkarkimin e ujit në rast të rritjes së sasisë së ujit. Kjo digë, që nga ndërtimi i saj është dëmtuar dy herë gjatë vërshimeve, së pari në vitin 2016 dhe më pas në janar 2021, pasi në pjesën e poshtme të digës është shkaktuar gërryerje”, ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (9)

# Deklarata e dëshmitarit kyç lidhur me 'Rastin Paraqini'



Lulzim SAHITI

Meqenëse dëshmitari kryesor i ngjarjes së Paraqinit ishte dhjetari Rizo Alibashiq nga Bosnja dhe Hercegovina, Haviz Xhakli, xhaxhai i Rizahut kishte vënë kontakt telefonik me këtë dëshmitar kyç të "Rastit të Paraqinit", i cili në atë kohë kishte përfunduar vuajtjen e dënimit. Atë e kishte lutur që ta bënte një deklaratë pa asnjë ndikim në lidhje me ngjarjen e vërtetë të Paraqinit dhe ky dokument shumë i rëndësishëm ishte vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale të Graçanicës në Bosnjë-Hercegovinë. Deklaratën në fjalë Hafiz Xhakli e kishte marrë përmes postës, më 28.04.1998. Duke ditur se historia për "Rastin e Paraqinit" për shumëkënd deri më sot ka qenë kontradiktore për të mësuar më shumë rreth të vërtetës së kësaj ngjarje historike, lexuesi ka mundësi ta ketë në dispozicion këtë dokument origjinal të përkthyer në gjuhën shqipe:

DEKLARATË

*Unë, Rizo Alibashiq, djali i Avdiut, lindur I0. 05. 1967 në Babiq, komuna e Graçanicës, Bosnjë dhe Hercegovinë, ku edhe jetoj, në "procesin e Paraqinit", si i akuzuari i shtatë, i dënuar me kohëzgjatje 14 vjet burg, pa prova faktike të vërtetuara plotësisht (materiale të pavërtetuara dhe të pabazuara), vullnetarisht, pa detyrim dhe pa ndikim deklaroj:*

*Si ushtar-dhjetar, pasi përfundova trajnimin tim, u transferova nga Zajeçari në Paraqin në PU 5513, nga ku u transferova më 18 shtator 1987 në Nish, në policinë ushtarake, ku isha deri në arrestim më 23 shtator 1987.*

*Në PU 5313 kam kryer detyrat e kujdestarit të kompanisë dhe komandantit të rojës. Ushtarin Aziz Kelmendin nuk e kam njohur (ka qenë në njësinë tjetër) deri në ditën kur u përlesh me ushtarin Safet Dudakoviq në kuzhinë nga kur ushtari Dudakoviq shpesh provokon ushtarin Kelmendi në prani të ushtarëve të tjerë që përkrahnin Dudakoviqin e ku Kelmendi as Dudakoviqit dhe as ushtarëve të tjerë nuk u jepte asnjë arsye për provokim. Për më tepër, ushtari Kelmendi shmangte Dudakoviqin dhe nuk i përgjigjej provokimeve të tij.*

*Më 30 gusht 1987, si kujdestar kompanie, ushtari Miodrag Vukoviq, në prani të disa ushtarëve më njoftoi se ushtari Kelmendi i kishte vjedhur portofolin që ishte në bluzën e tij të cilën e kishte hequr dhe e kishte vënë pranë fushës sepse po luante basketboll. Unë e informova oficerin kujdestar për këtë, kështu që pas një kohe ushtarët më thirrën dhe më thanë se e kishin gjetur një portofol në dhomën ku flinte ushtari Vukoviq edhe atë nën dyshekët e paluar në një shtrat ku askush nuk flinte. Portofolin e kam marrë dhe e kam dërguar te oficeri kujdestar, i cili telefonoi Vukoviqin dhe Vukoviq vërtetoi se nuk i mungonte asgjë nga portofoli i tij.*

*Atë mbrëmje, rreth orës 20:00, në kohë kur oficeri kujdestar po verifikonte numrin e ushtarëve, filloi një grindje e pastaj një rrahje mes ushtarit Kelmendi dhe Vukoviq, në të cilën u përfshinë edhe ushtarë të tjerë.*

*Së bashku, oficeri kujdestar dhe unë, kemi vendosur rregull duke përcjell ushtarët në dhomat e tyre. Pastaj, ndërmjet Kelmendit dhe Vukoviqit, dhe ushtarëve të tjerë, asgjë nuk ka ndodhur deri në natën fatale.*

*Në dosja gjyqësore ndodhen informatat në lidhje me atë që ndodhi natën fatale. Sidoqoftë unë deklaroj se nuk kishte asnjë marrëveshje midis meje dhe Rizah Xhaklit për dhënien e municionit Kelmendit. Ajo që në këtë drejtim gjatë procedurës kam pranuar është një "përpunim" i veçantë për të cilin isha i detyruar nga autoritetet hetuese. Ky "përpunim" u zhvillua nga sjellja kulturore me një kafe, pastaj me kërcënim dhe fyerje (nacionalist, irredentist, shovenist, etj.) se do të fajësohem si aktori kryesor e deri te maltretimi fizik (policia ushtarake vazhdimisht më rrahte pa ndonjë arsye, në izolim) pasojat e të cilës rrahje edhe sot i ndiej.*

*Kjo sjellje më theu-dërmoi, kështu që pas pranimeve dhe mohimeve të përsëritura përfundimisht kam pranuar atë që u duhej autoriteteve hetuese.*

*Gjithashtu, dua të përmend se Rizah Xhakli ishte një ushtar shembullor që dëshironte të kryente shërbimin ushtarak me nder dhe sinqeritet dhe asnjëherë nuk ka qenë i ftuar për të dhënë përgjegjësi dhe nga sjellja e tij ai fitoi admirues të tjerë të të gjitha nacionaliteteve dhe kurrë nuk ka treguar urrejtje ndaj ushtarëve të tjerë siç përshkruhen nga autoritetet në procedurat gjyqësore.*

*Dhe në fund vërtetoj se ushtari Aziz Kelmendi, veprën që ka kryer, nuk e bëri me motive nacionaliste, siç thuhet në aktgjykim, por nën ndikimin e një ngarkese psikike negative, të cilën e shkaktuan të tjerët duke e provokuar dhe ngacmuar vazhdimisht.*

*Në Graçanicë, më 27.04.1998*

*Deklaratën e dha: Rizo Alibashiq*

*(Vijon)*



Studenti i drejtësisë, Aziz Kelmendi (1967-1987)



IZJAVA

Ja, Rizo Alibašić, sin Avdije,rod. 10.05.1967.godine u Babićima, opština Gračanica,BiH, gdje i živim, u Paraćinskom procesu", kao sedmooptuženi, osuđen na kaznu zatvora u trajanju od 14 godina, zbog pogrešno i nepotpuno utvrđenog činjeničnog stanja (neutvrđene materijalne istine), dobrovoljno , bez ičijeg nagovora i prisile

i z j a v l j u j e m

Kao vojnik-desetar, nakon završene obuke, prekomandovan sam iz Zaječara u Paraćin u VJ 5313, odakle sam 18.09.1987.godine prekomandovan u Niš , u vojnu policiju, gdje sam bio sve do hapšenja 23.09.1987.godine.

U VJ 5313 obavljao sam dužnosti dežurnog u četi i komandira straže. Vojnika Aziza Keljmendija nisam poznavao (bio je u drugoj jedinici) sve do dana kada se je sukobio sa vojnikom Safetom Dudakovićem u trpezariji, od kada vojnik Duduković često provocira vojnika Keljmendija u prisustvu drugih vojnika, koji podržavaju Dudakovića, a da Keljmendi ni Dudakoviću, ni drugim vojnicima, ne daje uopšte povoda za provociranje. Što više, vojnik Keljmendi izbjegava Dudakovića i ne odgovara na njegove provokacije.

Dana 30.08.1987.godine, kao dežurnog u četi, vojnik Miodrag Vuković u prisustvu nekoliko vojnika, obavjestio me je da mu je vojnik Keljmendi ukrao novčanik koji je bio u njegovoj košulji, koju je skinuo i stavio pored igrališta, jer je igrao košarku. O ovome sam obavjestio dežurnog oficira, da bi me nakon vremena pozvali vojnici i saopštili mi da su pronašli novčanik u sobi u kojoj je spavao vojnik Vuković, i to ispod naslaganih dušeka na krevetu na kome nije niko spavao. Novčanik samo odnio do dežurnog oficira, koji je pozvao Vukovića, a Vuković je utvrdio da mu iz novčanika ne nedostaje ništa. Te večeri, oko 20.00 sati, u vrijeme kada je dežurni oficir uzimao brojno stanje, došlo je do svađe, a onda i do tuče između vojnika Keljmendija i Vukovića, u koju su se umiješali i drugi vojnici. Zajedno, dežurni oficir i ja, uspostavili smo red, otpremivši vojnike u njihove spavaonice. Nakon ovoga, između Keljmendija i Vukovića i drugih vojnika, nije se više ništa događalo do kobne noći.

U sudskom spisu se nalaze podaci o tome šta se dogodilo kobne noći. Međutim, tvrdim da između mene i Rizaha Džaklija nije postojao dogovor oko davanja municije Keljmendiju. To što sam u tom pravcu, u toku postupka dao priznanje, posljedica je posebne "obrade" kojoj sam bio izložen od strane istražnih organa. Ta obrada kretala se od kulturnog ispitivanja uz kafu, preko prijetnji i vrijeđanja (nacionalista,iredentista,šovinista i dr.) da ću biti okrivljen kao glavni akter, do fizičkog maltretiranja (vojna policija me je stalno tukla bez povoda, u samici) čije posljedice i danas osjećam. Takvo postupanje me je slomilo, tako da sam nakon višekratnog priznavanja i negiranja, konačno dao "priznanje" koje je trebalo istražnim organima.

Takođe, želim da napomenem da je Rizah Džakli bio primjeran vojnikkoji je želio odslužiti vojni rok časno i pošteno i nikad nije bio pozivan na odgovornost a svojim ponašanjem stekao je mnoge prijatelje svih nacionalnosti i nikad nije ispoljavao mržnju prema drugim vojnicima kao što su prikazali istražni organi u sudskom postupku.

I na kraju, tvrdim da vojnik Aziz Keljmendi, djelo koje je izvršio, nije izvršio iz nacionalnih pobuda, kako to stoji u presudi već djelo je izvršio pod uticajem negativnog psihičkog naboja, kojeg su u njemu izazivali drugi, stalno ga šikanirajući i provocirajući.

U Gračanici, 27.04.1998. godine.

Izjavu dao:
Rizo Alibašić
Rizo Alibašić

TILLE
( octobre 1961.)

1. Zemlja: BOSNA I HERCEGOVINA
Da je ova javna isprava
2. potpisana od strane Alibašić Rizo
3. u svojstvu davaoc izjave
4. snabdjevena pečatom,žigom Općinski sud Gračanica
tvrdi
5. u Gračanici 6. na dan 27.4.1998
7. (naziv organa vlasti) Općinski sud Gračanica
8. pod br. Ov H 610/98
9. Pečat (zig): 10. Potpis:

Faksimile nga deklarata e Rizo Alibashiqit e vërtetuar nga Gjykata Komunale e Graçanicës në Bosnjë e Hercegovinë. Ky dokument origjinal në gjuhën serbokroate është përkthyer në gjuhën shqipe nga Ibrahim Demiri.



Rizo Alibashiq, dëshmitari kryesor i ngjarjes së Praqinit




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Federata e Gjimnastikës shpall më të mirët e vitit 2020

Valëza Rama nga Klubi i Gjimnastikës "Elita" është shpallur sportiste e vitit 2020, kurse sportist i vitit është shpallur Elvis Çitaku nga Klubi i "Universitetit"





Prishtinë, 24 janar - Federata e Gjimnastikës e Kosovës të shtunën ka shpallur më të mirët e vitit 2020. Në fillim të ceremonisë për shpalljen e më të dalluarve për vitin që e lamë pas, kryetari FGjK-së, Besim Halilaj, ka falënderuar të gjithë sportistët, trajnerët, prindërit, MKRS-në, KOK-un, Departamentin e Sportit dhe mediat për kontributin e dhënë për zhvillimin dhe avancimin e sportit të gjimnastikës në vendin tonë.

Njëshi i gjimnastikës në Kosovë ka njoftuar se së shpejti do të fillojë bashkëpunimi në mes të FGjK-së dhe Federatës së Gjimnastikës së Kroacisë si dhe themelimi i një lige ballkanike.

Valëza Rama nga Klubi i Gjimnastikës "Elita" është shpallur sportiste e vitit 2020, kurse sportist i vitit është shpallur Elvis Çitaku nga Klubi i "Universitetit". Gjimnastja elitare Valëza Rama, po ashtu, me vlerësim pikësh është shpallur kampione e Kosovës në gjimnastikën artistike, kurse nënkampione është shpallur Vilëza Zeqiri. Vendin e tretë ka zënë Rizonë Mustafa po nga Klubi i "Elitës" nga Prishtina.

Sportiste e vitit për kategorinë Para-Yllka është shpallur Dielllona Azemi nga Klubi "Fushë Kosova" si dhe janë shpallur shpresat olimpike për këtë kategori: Elma Gashi (Kulina), Tara Dejta (Kulina), Dorlea Sherifi (Ferizaj), Jora Gërvalla (Omnisport), Una Kajtazi (Omnisport). Në kategorinë Yllka sportiste e vitit është shpallur Vlera Gërguri (Fushë-Kosovë), derisa shpresa olimpike janë shpallur: Jara Hasolli (Fushë Kosova), Fllanza Imeri (Kulina), Eriona Arifi (Ferizaj), Olisa Arifi (Elita), Liza Lohaj (Ferizaj), Riana Fejzullahu (Elita), Norana Sejdiu (Ardhmëria), Leona Berisha (Elita), Vesa Sadiku (Ferizaj), Erisa Gashi (Kulina).

Sportiste e vitit në kategorinë Para-Pioniere është shpallur gjimnastja e klubit "Elita", Bora Hoti. Shpresat olimpike në këtë kategori janë shpallur: Albiona Shabani (Vushtrri), Elena Sefa (Elita), Erza Obrazhda (Ferizaj), Elda Krasniqi (Universiteti), Eliza Ramadani (Halil Alidema).

Në kategorinë pioniere është shpallur Valëza Rama nga klubi "Elita", derisa shpesa olimpikë janë shpallur: Vilëza Zeqiri (Elita), Yvesa Islami (Ferizaj), Elena Manxholli (Fushë Kosovë), Jarita Bislimi (Elita), Edisona Aliu (Ferizaj), Sara Maliqi (Omnisport). Në kategorinë junior më e mira është shpallur Lisa Zeqiri nga klubi "Elita", derisa sportiste të dalluara janë shpallur: Ornela Karaliti (Ferizaj), Aksel Murtezi (Halil Alidema), Eljesa Kaçiu (Universiteti), Xhevrije Fetahu (Fushë Kosovë), Anita Mustafa (Ferizaj), Erinesa Qamili (Ferizaj). Rizonë Mustafa nga klubi "Elita" është shpallur sportiste e vitit në kategorinë seniore, kurse Fitore Rudari e Klubit "Elita" është shpallur sportiste e dalluar.

Akil Hetemi i Klubit "Ferizaj" është shpallur sportit i vitit në kategorinë fatosat.

Në kategorinë Para-Pionierë është shpallur sportist i vitit Aris Mernica nga Klubi "Vushtrria", kurse sportistë të dalluar janë shpallur Dite Behluli (Omnisport) dhe Vincenzo Del Re (Omnisport). Në kategorinë e pionierëve është shpallur më i miri Artur Merovc "Vushtrri". Në kategorinë juniorë sportist i vitit është shpallur Taulant Ramadani nga Klubi "Ferizaj". Në kategorinë seniorë sportist i vitit është shpallur Elvis Çitaku nga Klubi "Universiteti", kurse sportist të dalluar janë shpallur Dijon Mahmuti nga Klubi "Ferizaj", Elion Vitia nga Klubi "Universiteti", Aid Hoxha nga Klubi "Universiteti" dhe Ardi Halili nga Klubi "Ferizaj".

Abeliana Bregu është shpallur trajnerja më e mirë e vitit 2020 në gjimnastikën artistike për femra, kurse Amir Tahiraga është shpallur trajneri më i mirë i vitit 2020 në gjimnastikën artistike për meshkuj. Gjyqtari i vitit 2020 në gjimnastikën artistike për femra dhe meshkuj është shpallur Arlind Shaqiri.













## Prishtina, fituese e Superkupës

PRISHTINË, 24 JANAR - FC Prishtina është fituese e Superkupës së Kosovës në futboll. Takimi i zhvilluar të shtunën në mesditë në Antalia të Turqisë u takoi kryeqytetasve që mposhtën gjilanasit e Dritës me rezultatin 3-1. Fituesja e trofeut të Kupës, Prishtina, kaloi në epërsi në minutën e tretë me golin e Qendrim Zybës. Katër minuta më vonë u kundërpërgjigj Kastriot Rexha, i cili barazoi shifrat duke e shfrytëzuar edhe gabimin e portierit Eglant Haxho. Në minutën e 22-të, Prishtina e ktheu avantazhin. Mbrojtësi Besnik Krasniqi e konvertoi në gol penalltinë e fituar nga Leonit Abazi. Goli i fundit nga Prishtina në këtë duel u shënua në minutën e tretë të kohës shtesë. Alban Shillova vulosi epilogun final të takimit, Prishtina - Drita 3-1. Superkupa e Kosovës u zhvillua për herën e parë jashtë territorit të Kosovës, me pajtim të të dyja klubeve, që po qëndrojnë në Turqi për përgatitje para stinorit pranveror. Prishtina e Drita do të takohen në stadiumin "Fadil Vokrri" më 10 shkurt edhe në kuadër të Kupës së Kosovës në fazën e 1/8 së finales.



# Ylli vazhdon me fitore, Bashkimi e mposhti Vëllaznimin



MITROVICË, 24 JANAR - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Trepçës në udhëtim me rezultat 72:78 (19:25, 23:12, 21:17, 9:24), në kuadër të javës së 17-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte i baraspeshuar, por në minutat e fundit, Ylli shkëputet dhe fiton pjesën e parë 19:25. Rikthimi i Trepçës nuk vonoi dhe e filloi për mrekulli periudhën e dytë, derisa 3 minuta para fundit të pjesës së parë kalojnë në epërsi 33:32 dhe përmbyll pjesën e parë me shifrat 42:37. Në periodën e tretë mysafirët ngushtuan shifrat në 47:46, por vendasit me një seri të suksesshme sërish shkëputen, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:54. 10 minutat e fundit ishin shumë interesante dhe dramatike. Ylli duke pasur edhe bankën më të mirë rezervë dha maksimumin në periudhën e fundit, duke shkrirë epërsinë e vendasve dhe kaloi në epërsi 69:74, kurse triumfoi në fund 72:78. Te Trepça u dalluan Ivan Koljeviq me 14 pikë, nëntë kërcime dhe shtatë asistime, Dillon Smith me 16 pikë, Toutiazarkis Stavros me 14 dhe Drilon Hajrizi me 12 pikë e nëntë kërcime, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan Mitchell Wilbekin me 24 pikë, Erjon Kastrati me 15, Valon Bunjaku me 14 dhe Gëzim Morina me 12 pikë e tetë kërcime. Trepça ka katër fitore dhe 13 humbje, kurse Golden Eagle Ylli 11 fitore dhe gjashtë humbje. Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit me rezultat 79:67 (23:20, 14:23, 17:16, 25:8), në ndeshjen e fundit të javës së 17-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte mjaft i baraspeshuar, derisa përfundon 23:20 për vendasit. Megjithatë, perioda e dytë foli në të mirë të skuadrës mysafire, që e fitoi 14:23, duke përfunduar pjesën e parë me rezultat 37:43. Epërsinë më të lartë kuqezinjtë e arritën në periodën e tretë, 37:46, por me kalimin e minutave, prizrenasit ngushtuan rezultatin, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 54:59. Në 10 minutat e fundit prizrenasit ishin bindshëm më të mirë, duke bërë përmbysjen e madhe, ku barazuan shifrat në 59:59 dhe krijuan epërsi konstante, ndërsa triumfuan në fund 79:67. Te Bashkimi u dalluan Endrit Hysenagolli me 20 pikë e 17 kërcime dhe Sean Hoehn me 25 pikë, kurse te Vëllaznimi u dallua Emmaneul Omogbo me 24 pikë e 12 kërcime. Bashkimi ka nëntë fitore dhe tetë humbje, kurse Vëllaznimi katër fitore dhe 13 humbje.

## SHKURT

### Lakersat mposhtin Chicagon

La Lakersi ka arkëtuar fitore ndaj Chicago Bullsit në udhëtim në kuadër të xhiros së 17-të të NBA-s. Bullsi kishte fituar tri ndeshje radhazi dhe kishte arritur një rekord ekskluziviteti duke shënuar 115 ose më shumë në shtatë ndeshje radhazi. Por kundër LA Lakersit ata u munduan, veçanërisht në fillim. Lakersi tani qëndron në vendin e parë me 13 fitore dhe katër humbje, të ndjekur nga rivali lokal Clippers. Mysafirët fituan dy çerekët e parë, ndërsa Bullsi fitoi dy të tjerë. Rezultati përfundimtar Chicago Bulls 90 - 101 LA Lakers (17-29), (16-34), (33-20), (24-18). Për Lakersin shkëlqeu Anthony Davis me 37 pikë, gjashtë kërcime dhe tri asistime. LeBron Jamesi regjistroi 17 pikë, 11 kërcime dhe gjashtë asistime. LaVine ishte më i dalluari te Chicago me 21 pikë, 10 kërcime dhe katër asistime.

### Rashani, afër transferimit në Erzurumspor

Elbasan Rashani është afër të transferohet në Turqi te skuadra e Erzurumsporit. Sulmuesi nga Kosova ishte pjesë e skuadrës norvegjeze Odd, ku kishte regjistruar 92 paraqitje dhe kishte shënuar 15 gola. Lajmi është bërë me dije përmes një postimi në rrjetin social "Instagram", Rashani ka bërë me dije transferimin e tij te skuadra turke, njëkohësisht edhe në llogarinë në "Instagram" të skuadrës Erzurumspor është shpërndarë video e Rashanit. Asgjë zyrtare deri tani, por që zyrtarizimi i Rashanit si lojtar i ri është çështje kohe.

### Toni: Lewandowski është më i miri

Luca Toni ka folur për sulmuesin më të mirë aktual në botë në një intervistë të dhënë për "Tuttosport". "Lewandowski është më i miri. Fizioterapisti që mora unë te Bayerni, Gianni Bianchi, më thotë se është një profesionist i jashtëzakonshëm. Nuk është një rastësi që luan pothuajse gjithmonë", ka thënë ish-sulmuesi italian i Bayernit. "Do të më pëlqente ta shihja Robertin në Itali, siç ka bërë Cristiano Ronaldo. Pas Lewandowskit, vendos Haalandin dhe Moratan. Lukaku? Është shumë i fortë, nuk diskutohet, por Lukaku ka nevojë që të ketë në krah një sulmues me karakteristika të caktuara. Morata, nga ana tjetër, luan mirë me këdo dhe për këtë arsye preferoj spanjollin", ka deklaruar Toni.

### Hertha shkarkon trajnerin dhe drejtorin sportiv

Hertha e Berlinit ka vendosur ta shkarkojë trajnerin Bruno Labbadia dhe drejtorin sportiv të skuadrës, Michael Preetz, pas një serie rezultatesh negative, që e kanë zbritur ekipin shumë pranë zonës së ftohtë të renditjes. Decizive për këtë shkarkim ishte humbja e djeshme e kryeqytetasve me rezultatin 4-1 ndaj Werder Bremenit, ndërsa Labbadia u bë trajneri i katërt që shkarkohet nga stoli i Herthës së Berlinit, në dy sezonet e fundit. Aktualisht klubi pozicionohet në vendin e 14-të të renditjes në Bundesligë dhe ka fituar vetëm një nga 8 ndeshjet e fundit të kampionatit gjerman, teksa edhe këtë sezon do të duhet të luftojë shumë për mbijetesën.

### Pioli: Atalanta e meritoi fitoren

Paraqitja më e keqe e Milanit këtë sezon ishte pa dyshim kjo e fundit ndaj Atalantës, në mbyllje të fazës së parë të Serisë A. Skuadra kuqezi megjithatë, është kampione e dimrit, pasi Interi nuk mundi ta merrte maksimumin e pikëve në Udinese. Stefano Pioli ka thënë se Atalanta e meritoi fitoren. "Atalanta është ekipi i vetëm që nuk kemi mundur të mposhtim, meritoi fitoren. Na vjen keq për mënyrën se si e morëm golin e parë, pastaj i dyti mbylli ndeshjen. Nuk duhej të ndodhte kështu, kishte kaq shumë për të luajtur", ka thënë Pioli. "Kishim nevojë të bënim më shumë dhe nuk ia dolëm. Ne mund të luajmë më mirë teknikisht, mjaftonte pak më shumë personalitet dhe saktësi. Ne duhet të rifillojmë me shumë besim, kemi treguar se kemi cilësi. Niveli i shtatë më të mirëve në kampionat është cilësor, nëse pragu i intensitetit ulet, kundërshtarët kanë më shumë avantazh", ka deklaruar Pioli.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS ME KOHË TË PACAKTUAR

**Titulli:** Statisticient i ri - Sektori i Statistikave të Llogarive Financiare
**Grada:** 7
**Departamenti:** i Statistikës
**Raporton tek:** Drejtori i Departamentit të Statistikës

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:**

- Zbaton programin e punës të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të njësisë së statistikave e llogarive financiare;
- Identifikon burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e statistikave për llogari financiare;
- Ndihmon BQK-në në themelimin e kornizës raportuese për mbledhje të të dhënave nga sektorët e nevojshëm institucional;
- Mbledhë të dhënat statistikore dhe i kontrollon ato; integron statistikat nga sektori financiarë dhe jofinanciare, dhe përpilon statistikat e sektorit të llogarive financiare në nivel vendi në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikat për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Departamentit të Statistikës;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët lidhur me çështjet statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë. Niveli i përfunduar i studimeve pasuniversitar është përparësi;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe në gjuhën angleze;.
- Të ketë aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë të paplanifikuara.
- Kandidati që ka njohuri të mira në zbatimin e teknikave moderne statistikore ka përparësi;
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit;

- **Përvoja e kërkuar:**
- Së paku një vit përvojë pune në fushat e listuar më sipër në pjesën "përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive" apo në përgatitjen e pasqyrave financiare të korporatave.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave. Diplomat e fituara jashtë vendi duhet të jenë të nostrifikuara;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **08 shkurt 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet on-line (https://hris.bqk-kos.org/) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr:8. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU NA NEODREĐENO VREME

**Naslov:** Novi statističar - Sektor statistike finansijskih računa
**Stepen:** 7
**Odeljenje:** Statistike
**Izveštava kod:** Direktora Odeljenja za statistiku

**Opis dužnosti i odgovornosti:**

- Sprovodi program rada Odeljenja za statistiku u skladu sa opisom dužnosti i odgovornosti statističke jedinice i finansijskih računa;
- Identifikuje glavne izvore podataka za sastavljanje statistika za finansijske račune;
- Pomaže CBK-u u uspostavljanju okvira izveštavanja za prikupljanje podataka iz potrebnih institucionalnih sektora;
- Prikuplja statističke podatke i kontroliše ih; integriše statistike iz finansijskog i ne finansijskog sektora i sastavlja statistiku sektora finansijskih računa na nacionalnom nivou u skladu sa međunarodnim standardima;
- Priprema statistike za periodične i ne periodične publikacije u skladu sa politikom publikacija i najboljom praksom u vezi sa širenjem statističkih informacija;
- Pruža mišljenja i preporuke o raznim pitanjima koji se odnose na prikupljanje, sastavljanje, validaciju i publiciranje statističkih podataka;
- Predlaže i aktivno učestvuje u izradi radnih procedura i drugih administrativnih dokumenata Odeljenja za statistiku;
- Održava potrebnu saradnju sa svim stranama u vezi sa statističkim pitanjima;
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornika.

**Potrebno znanje:**

- Univerzitetska diploma iz ekonomije. Završeni postdiplomski nivo je prednost;
- Da govori tečno albanski jezik i/ili srpski i engleski jezik;
- Da ima dobre sposobnosti za samostalan rad, kao i za konstruktivnost u timskom radu, kada su rokovi uski, a rasporedi neplanirani.
- Kandidat koji dobro znanje u sprovođenju modernih statističkih tehnika ima prednost;
- Kandidat mora da ima samoinicijativu, dobre sposobnosti komunikacije i koordinacije;

**Potrebno iskustvo:**

- Najmanje godinu dana radnog iskustva u oblastima navedenim gore u delu „opis dužnosti i odgovornosti" ili u pripremi finansijskih izveštaja korporacija.

**Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:**

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma. Diplome stečene izvan Republike Kosovo MONT mora službeno da ih prizna/nostrifikuje;
- Dokazi o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

**Procedura apliciranja:**

- Posljednji rod za apliciranje je **08. februar 2021. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (https://hris.bqk-kos.org) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a., br:8. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir.
- Obrazac za aplikaciju možete preuzeti putem službene interne stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće uzeti u obzir.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS ME KOHË TË PACAKTUAR

**Titulli:** Statisticient i ri – Sektori i Statistikave Monetare
**Departamenti:** i Statistikës
**Grada:** 7
**Raporton tek:** Drejtori i departamentit te statistikës

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:**

- Zbaton programin afatshkurtër të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të njësisë së statistikave monetare e financiare;
- Mbledhë, përpilon dhe validon statistikat monetare dhe financiare me qëllim të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes të funksionit statistikor në BQK në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikat për publikime periodike e jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Departamentit të Statistikës;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët lidhur me çështjet statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në fushën e matematikës ose statistikës. Niveli i përfunduar i studimeve pasuniversitar është përparësi;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe në gjuhën angleze;.
- Të ketë aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë paplanifikuara;
- Kandidati që ka njohuri të mira në zbatimin e teknikave moderne statistikore ka përparësi;
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

**Përvoja e kërkuar:**

- Së paku një vit përvojë pune në statistika apo në sektorin financiar.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **08 shkurt 2021.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU NA NEODREĐENO VREME

**Naslov:** Novi statističar – Sektor monetarnih statistika
**Odeljenje:** Statistike
**Stepen:** 7
**Izveštava kod:** Direktora Odeljenja za statistiku

**Opis dužnosti i odgovornosti:**

- Sprovodi kratkoročni program Odeljenja za statistiku u skladu sa opisom dužnosti i odgovornosti jedinice za monetarnu i finansijsku statistiku;
- Prikuplja, sastavlja i validira monetarne i finansijske statistike u cilju povećanja kvaliteta i uključivanja statističke funkcije u CBK u skladu sa međunarodnim standardima;
- Priprema statistike za periodične i ne periodične publikacije u skladu sa politikom publikacija i najboljim praksama u vezi sa širenjem statističkih informacija;
- Pruža mišljenja i preporuke o raznim pitanjima vezanim za prikupljanje, sastavljanje, potvrđivanje i objavljivanje statističkih informacija;
- Predlaže i aktivno učestvuje u izradi radnih procedura i drugih administrativnih dokumenata Odeljenja za statistiku;
- Održava potrebnu saradnju sa svim stranama u vezi sa statističkim pitanjima;
- Obavlja druge poslove na zahtev nadzornika.

**Potrebno znanje:**

- Univerzitetska diploma iz matematike ili statistike. Završeni postdiplomski nivo je prednost;
- Da govori tečno albanski jezik i/ili srpski i engleski jezik;
- Da ima dobre sposobnosti za samostalan rad, kao i za konstruktivnost u timskom radu, kada su rokovi uski, a rasporedi neplanirani;

  Kandidat koji ima dobro znanje u sprovođenju modernih statističkih tehnika ima prednost;
- Kandidat mora imati samoinicijativu, dobre sposobnosti komunikacije i koordinacije.

**Potrebno iskustvo:**

- Najmanje godinu dana radnog iskustva u statistikama ili u finansijskom sektoru.

**Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:**

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo MONT mora službeno da ih prizna/nostrifikuje;
- Dokazi o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

**Procedura apliciranja:**

- Posljednji rod za apliciranje je **08. februar 2021. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (https://hris.bqk-kos.org) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir.
- Obrazac za aplikaciju možete preuzeti putem službene interne stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće uzeti u obzir.**










**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Jashar Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Xhemile Halimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI-IX shfmu "Mati Llogoreci" Prizren.

▶ Hidajete Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl. V dhe VI-IX shfmu" Dy Dëshmorët" Pirane.

▶ Samir Ibishi shpall të pavlefshme dëftesat e SHMLM "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

▶ Gazmend Kosumi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12,13 të SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

▶ Hysnije Perçuku shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit 3,4 të Shmlm "Dr Xheladin Deda"

▶ Zeqir Musa shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Hana Shala shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abdullah Shabani"

▶ Muhamet Behrami shpalle te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore "Azem Bejta"

▶ Veli Cimili shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Trepca"

▶ Nuradin Nebihu shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 810349945

▶ Daut Mustafa shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit X te Shmlt "Arkitekt Sinani"

▶ Qendrim Hoti shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymber Kelmendi**

***

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

***

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

***

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

***

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ISBN 978-9951-780-37-7

**ÇMIMI: 5.99 €**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI

ARMAGEDONI



AGRON SHALA

# DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

---



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re,* pastaj në revistën *Zëri.* Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.
*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

ISBN 978-9951-780-10-0

**4,99 €**

Daut Dauti • NJË PALË KËPUCË NË BERLIN



Daut Dauti

# NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

*novelë*

ARMAGEDONI


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L